# AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
# 2027-2030

**09 Qershor 2026**

# Përmbajtja

**SHKURTIME** ..... 3

**PJESA 1: KONTEKSTI STRATEGJIK** ..... 5

**I.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit** ..... 5

**I.2 Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional** ..... 6

**I.3 Vizioni i strategjisë dhe qëllimet strategjike** ..... 12

**Përfshirja e aktorëve dhe grupeve të interesit** ..... 13

**PJESA II. QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË KUADRIT STRATEGJIK** ..... 19

**Qëllimi strategjik I: Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore për të garantuar një sistem të mirë koordinuar dhe të financuar, që mundëson respektimin, mbrojtjen, përmbushjen dhe monitorimin efektiv të të drejtave të fëmijëve.** ..... 19

**Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve** ..... 20

**Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike** ..... 28

**PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI** ..... 34

**III.1 Zbatimi i AKDF-së** ..... 34

**III.2 Monitorimi dhe raportimi** ..... 35

**III.3 Vlerësimi** ..... 36

**PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE** ..... 36

**ANEKS 1 - MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT** ..... 46

**ANEKS 1 - MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT** ..... 65

**AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2027-2030** ..... 65

**ANEKS 2 – LISTA E INSTITUCIONEVE KONTRIBUESE NË AKDF DHE ORGANIZATAVE** ..... 103

# SHKURTIME

| | |
|---|---|
| AMA | Autoriteti i Mediave Audiovizive |
| AKDF | Agjenda Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve 2027-2030 |
| AKMC | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| AKKSHTI | Agjensia Kombëtare e Kerkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| AKSK | Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike |
| AMSHC | Agjensia për Mbështetjen e Shoqërive Civile |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| AP | Avokati i Popullit |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administrates Publike |
| ASHPSKN | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës |
| ASHDMF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës |
| ASCAP | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DAR/ZA | Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore |
| DHKA | Dhoma Kombëtare e Avokatisë |
| DKM | Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit |
| DPG | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave |
| DNJF | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPSHPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor Shtetëror |
| GMIP | Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave |
| GTN | Grupi Teknik Ndersektorial |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| ISHP | Inspektorati Shtetëror i Punës |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| KDPM | Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur |
| KKBDF | Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| KDIMDHP | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| KRAT | Komiteti Rajonal Anitrafik në Qark |
| KKDMF | Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës |
| KSHNJ | Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike |
| MA | Ministria e Arsimit |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MEPJ | Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme |
| MTKS | Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| NE | Ndihma Ekonomike |
| NJMF | Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës |
| NJVV | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore |
| NJVNR | Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit |

| | |
|---|---|
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetit |
| OJF | Organizata Jofitimprurëse |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| OSHC | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| OSHKSH | Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor |
| PMF | Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| QPKMR | Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| SKZHIE | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

# PJESA 1: KONTEKSTI STRATEGJIK

## I.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 (AKDF) përfaqëson kuadrin strategjik kombëtar të Republikës së Shqipërisë për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të çdo fëmije, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së fëmijëve.

AKDF synon të forcojë një sistem të integruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke garantuar akses të barabartë në shërbime cilësore, mbrojtje efektive nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, si dhe mundësi të barabarta për zhvillim, mirëqenie dhe pjesëmarrje për çdo fëmijë në Shqipëri.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 ndërtohet mbi progresin, arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, duke adresuar njëkohësisht sfidat e vazhdueshme dhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të qeverisjes, koordinimit ndërsektorial, financimit dhe monitorimit të politikave për fëmijët. Në këtë kuadër, AKDF synon të avancojë reforma të rëndësishme në fushën e mbrojtjes sociale, kujdesit alternativ, arsimit gjithëpërfshirës, shëndetit, drejtësisë miqësore për fëmijët, sigurisë digjitale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Dokumenti adreson gjithashtu sfidat e reja dhe në zhvillim që ndikojnë në jetën e fëmijëve, përfshirë ndryshimet demografike dhe socio-ekonomike, pabarazitë sociale dhe territoriale, transformimin digjital dhe rreziqet online, ndryshimet klimatike, migracionin dhe presionin në rritje mbi sistemet sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve. Në këtë drejtim, Agjenda promovon një qasje të bazuar në të drejta, parandalim, ndërhyrje të hershme, reziliencë dhe zhvillim të kapitalit njerëzor, duke vendosur fëmijën në qendër të politikave publike.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 është gjithashtu një instrument i rëndësishëm për avancimin e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe harmonizimin e politikave kombëtare me acquis dhe standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve, Garancinë Evropiane për Fëmijët, Garancinë për të Rinjtë dhe prioritetet e identifikuara në Raportet e Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Përmes kësaj qasjeje, Agjenda kontribuon në forcimin e qeverisjes demokratike, kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke synuar ndërtimin e një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës për çdo fëmijë.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 mbështetet në një sërë parimesh themelore që do të udhëheqin hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e saj, me qëllim garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të bazuar në të drejtat e fëmijës.

**Qasja e bazuar në të drejtat e fëmijës** përbën parimin themelor të Agjendës, duke garantuar harmonizimin e plotë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë. Në të gjitha politikat dhe masat e

parashikuara do të integrohen parimet e interesit më të lartë të fëmijës, mosdiskriminimit, mbijetesës dhe zhvillimit, pjesëmarrjes së fëmijëve dhe llogaridhënies institucionale.

**Pjesëmarrja dhe përfshirja** do të jenë elemente kyçe të Agjendës, duke siguruar përfshirjen kuptimplotë të fëmijëve dhe adoleshentëve në proceset e konsultimit, vendimmarrjes dhe monitorimit të politikave që i prekin ata. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet grupeve vulnerabël dhe të margjinalizuara, përmes metodave të sigurta, etike, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura sipas moshës dhe nevojave të fëmijëve.

**Hartimi i politikave të bazuara në evidencë** do të orientojë përcaktimin e prioriteteve, objektivave dhe masave të Agjendës, duke u mbështetur në të dhëna të besueshme, analiza statistikore, rezultate monitorimi, vlerësime, studime dhe kërkime kombëtare dhe ndërkombëtare mbi situatën e fëmijëve në Shqipëri. Kjo qasje synon të forcojë efektivitetin, cilësinë dhe ndikimin e politikave publike për fëmijët.

**Koordinimi ndërsektorial dhe përgjegjësia institucionale** përbëjnë një tjetër parim thelbësor të Agjendës. Dokumenti promovon një qasje të integruar ndërmjet sektorëve të mbrojtjes sociale, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, sigurisë, financave dhe qeverisjes vendore, nën drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe në koordinim të ngushtë me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Zbatimi efektiv i Agjendës kërkon angazhim aktiv, bashkëpunim institucional dhe përgjegjësi të përbashkët nga të gjitha institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

**Harmonizimi me standardet e Bashkimit Evropian dhe procesin e integrimit evropian** përbën një dimension të rëndësishëm të Agjendës 2027–2030. Në këtë kuadër, dokumenti merr në konsideratë standardet, politikat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave të fëmijëve, përfshirjes sociale, mbrojtjes sociale, drejtësisë miqësore për fëmijët dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

## I.2 Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

### 2.1 Harmonizimi i Agjendës me Kuadrin Ndërkombëtar dhe Evropian për të Drejtat e Fëmijëve

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 është hartuar në përputhje me standardet, rekomandimet dhe kuadrin politik ndërkombëtar dhe evropian në fushën e të drejtave të fëmijëve, me qëllim garantimin e koherencës ndërmjet prioriteteve kombëtare dhe detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë. Ky proces u mbështet në:

- Rekomandimet Përfundimtare të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023);
- Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2024);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQs) të lidhura me fëmijët dhe mirëqenien e tyre;
- Politikat dhe iniciativat e Bashkimit Evropian, përfshirë Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve, Garancinë Evropiane për Fëmijët dhe iniciativa të tjera relevante të BE-së;

- Prioritetet dhe rekomandimet e identifikuara në Raportin e Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë (2025).

Në mënyrë të veçantë, Agjenda mori në konsideratë dhe do të referojë dokumentet dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane, ndër të cilat:

- Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës 2022–2027;
- Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve;
- Garancia Evropiane për Fëmijët (European Child Guarantee);
- Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë 2025;
- Rekomandimi i Komisionit Evropian, datë 23.04.2024, për zhvillimin dhe forcimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve në interesin më të lartë të fëmijës;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 13 (2011) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, mbi të drejtën e fëmijës për të qenë i lirë nga të gjitha format e dhunës;
- Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025;
- Kuadri i ri strategjik i BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve rome;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 12 (2009) mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar;
- Rekomandimi CM/Rec(2012)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nën moshën 18 vjeç;
- Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023).
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës i datës 8 dhjetor 2022 mbi edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme: objektivat e Barcelonës për vitin 2030[1]

## 2.2 Harmonizimi me Strategjitë dhe Politikat Kombëtare Ndërsektoriale

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 është hartuar në koordinim të ngushtë me strategjitë dhe planet kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale, me qëllim garantimin e koherencës së politikave publike, shmangien e mbivendosjeve institucionale dhe maksimizimin e sinergjive ndërmjet sektorëve që ndikojnë në të drejtat, mbrojtjen, zhvillimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve. Kjo qasje synon të sigurojë që të drejtat e fëmijëve të integrohen në mënyrë horizontale në politikat kombëtare të arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, transformimit digjital, përfshirjes sociale dhe zhvillimit ekonomik.

Në këtë kuadër, Agjenda harmonizohet dhe ndërvepron me dokumentet strategjike kombëtare më të rëndësishme, ndër të cilat:

1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
2. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
3. Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022–2029;
4. Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2024–2028 në Republikën e Shqipërisë;
5. Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë për të Mitur 2022–2026, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve 2022–2026;
6. Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026;
7. Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut;
8. Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030;
9. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030;
10. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026;

[1] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32022H1220(01)

11. Plani i Veprimit i Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030 dhe standardet për arritjen e kompetencave digjitale, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 03.12.2025;
12. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave dhe procesi për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2026–2030;
13. Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt shërbimeve alternative për fëmijën dhe familjen 2025-2027;
14. Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030;
15. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025;
16. Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2021–2025;
17. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.

Përmes këtij harmonizimi, Agjenda 2027–2030 synon të forcojë koherencën ndërmjet reformave sektoriale dhe prioriteteve kombëtare për fëmijët, të mbështesë zhvillimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të sigurojë një qasje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në adresimin e nevojave të tyre.

## 2.3 Arritjet, analiza dhe sfidat

Në vitin 2025, Shqipëria avancoi ndjeshëm procesin e integrimit europian duke hapur të gjashtë grup-kapitujt e negociatave me Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, çështjet e të drejtave të fëmijëve, përfshirjes sociale, arsimit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor fituan një rëndësi më të madhe në dialogun politik të lidhur me procesin e anëtarësimit në BE.

Shqipëria renditet e 45-ta nga 167 vende në Indeksin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG Index) për vitin 2025[2], duke reflektuar progres në qeverisje dhe reforma institucionale, por duke vijuar të përballet me sfida të rëndësishme që lidhen me varfërinë e fëmijëve, pabarazitë dhe aksesin e pabarabartë në shërbime, veçanërisht për fëmijët në zonat rurale, familjet e mëdha dhe komunitetet e margjinalizuara.

Raportet e Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, Rekomandimet Përmbyllëse të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023)[3], si dhe raporte të institucioneve të tjera ndërkombëtare evidentojnë se, megjithëse Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijëve, mbeten sfida të konsiderueshme në garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore, forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe në reduktimin e pabarazive sociale dhe territoriale që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Fëmijët e lindur sot në Shqipëri pritet të arrijnë vetëm 63% të potencialit të tyre produktiv në moshë madhore, nën mesataren rajonale prej 69%, duke treguar nevojën për investime më të forta në zhvillimin e hershëm, arsim cilësor, mbrojtje sociale dhe mirëqenie të fëmijëve dhe të rinjve[4].

[2] https://dashboards.sdgindex.org/
[3] https://www.ecoi.net/en/file/local/2098877/G2319930.pdf
[4] https://thedocs.worldbank.org/en/doc/64e578cbeaa522631f08f0cafba8960e-0140062023/related/HCI-AM23-ALB.pdf

Gjithashtu, të dhënat e Censusit 2023 evidentojnë rënie të përshpejtuar të popullsisë, emigracion të lartë dhe zgjerim të pabarazive territoriale, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin e fëmijëve në shërbime dhe në zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor të vendit.

Raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 evidenton progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit institucional, ligjor dhe programor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithëse mbeten ende sfida të rëndësishme në drejtim të zbatimit të plotë, koordinimit ndërsektorial dhe garantimit të aksesit të barabartë në shërbime cilësore për çdo fëmijë.
Gjatë periudhës 2021–2025 janë raportuar 170 nga 185 aktivitetet e planifikuara në Agjendë (92%), ku 64% e aktiviteteve rezultojnë plotësisht të realizuara, 27% pjesërisht të realizuara dhe 9% të parealizuara. Nga 20 tregues strategjikë të rezultateve, institucionet kanë raportuar për 17 prej tyre, ku 77% konsiderohen plotësisht të realizuar dhe 18% pjesërisht të realizuar.

Në aspektin institucional dhe të qeverisjes, është forcuar roli i strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e të drejtave të fëmijëve, përfshirë Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe mekanizmat vendorë të mbrojtjes së fëmijëve. Numri i Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve ka arritur në 370 në nivel kombëtar, duke përmirësuar identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Përgjatë viteve 2021–2024 janë menaxhuar 4,447 raste të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe viktima të dhunës seksuale.

Miratimi i Ligjit për Kujdesin Alternativ në Familje përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në kuadër të reformës së deinstitucionalizimit dhe forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Ligji mbështet tranzicionin nga kujdesi institucional drejt modeleve të kujdesit me bazë familjare dhe komunitare, duke promovuar zgjidhje më të qëndrueshme dhe në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Ky zhvillim harmonizon praktikat kombëtare me rekomandimet përfundimtare Komitetit për të Drejtat e Fëmijës në raportimin e fundit (viti 2023), si edhe me piketat kryesore të përcaktuara nga Komisioni Evropian në kuadër të procesit të negociatave për Kapitullin 23 (“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”), në seksionin për të drejtat e fëmijës dhe përfshirjen sociale.
Raporti i monitorimit evidenton gjithashtu progres në zgjerimin e shërbimeve sociale dhe transformimin e kujdesit rezidencial drejt modeleve komunitare dhe familjare.

Përmes Fondit Social janë krijuar 98 shërbime të kujdesit social, ndër të cilat 32 të dedikuara për fëmijët, duke mbështetur mbi 62 mijë përfitues në nivel kombëtar. Gjithashtu, është avancuar procesi i deinstitucionalizimit dhe janë ngritur 7 shërbime mbështetëse për fëmijën dhe familjen në 7 bashki të vendit Në këtë kuadër, reforma e deinstitucionalizimit është shoqëruar me transformimin gradual të dy shërbimeve rezidenciale në shërbime alternative komunitare dhe familjare, duke i dhënë prioritet fuqizimit ekonomik dhe social të familjeve dhe parandalimit të ndarjes së fëmijëve nga mjedisi familjar. Në bashkitë Korçë, Vlorë, janë transformuar shërbimet rezidenciale për fëmijët e moshës 0–5 vjeç në shërbime komunitare “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen/Hub”, me fokus parandalimin e institucionalizimit dhe ofrimin e mbështetjes së integruar për fëmijët dhe familjet në komunitet. Po vijon procesi dhe për transformimin e kësaj tipologjie shërbimi në dy bashki të tjera, në Durrës dhe Shkodër.

Megjithatë, analiza evidenton se procesi kërkon investime të mëtejshme në zhvillimin dhe shtrirjen territoriale të shërbimeve komunitare, standardizimin e modeleve alternative të kujdesit, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe sigurimin e financimit të qëndrueshëm për garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore për çdo fëmijë në të gjithë territorin e vendit.

Sipas raportit të monitorimit në sektorin e arsimit dhe zhvillimit të fëmijëve janë shënuar zhvillime pozitive në drejtim të gjithëpërfshirjes, mbështetjes psikosociale dhe sigurisë në shkolla. Janë zgjeruar shërbimet psikosociale në institucionet arsimore, është rritur numri i oficerëve të sigurisë dhe janë forcuar mekanizmat për parandalimin e dhunës dhe bullizmit.

Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë 2025 evidenton se sektori i arsimit vazhdon të përballet me sfida strukturore, përfshirë rezultatet e ulëta në të nxënë, kompetencat digjitale nën mesataren e BE-së, mungesën e mësuesve në zonat e largëta dhe pabarazitë në aksesin ndaj shërbimeve cilësore.

Programet e shëndetit të fëmijëve kanë qenë një komponent thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë periudhës 2021–2025, me fokus në parandalimin, kujdesin bazë dhe shërbimet e integruara sociale dhe shëndetësore të ofruara në qendrat e kujdesit parësor. Këto programe kanë përfshirë kontrollin e shikimit, kujdesin dentar, vaksinimin kombëtar dhe shërbimet shëndetësore në shkolla. Nga viti 2022 deri në fund të qershorit 2025 kanë përfituar:

- 314,746 fëmijë nga Programi Kombëtar i Shikimit (265,584 gjatë viteve 2022–2024 dhe 49,162 gjatë periudhës janar–qershor 2025);
- 686,448 fëmijë nga programi i kujdesit dentar për grupmoshën 6–14 vjeç (603,622 gjatë viteve 2022–2024 dhe 82,826 gjatë periudhës janar–qershor 2025).

Gjatë së njëjtës periudhë, të gjithë fëmijët kanë përfituar nga Programi Kombëtar i Vaksinimit, i cili përfshin edhe vaksinën Human papilloma virus (HPV) për vajzat adoleshente. Vetëm në gjysmën e parë të vitit 2025, 4,025 vajza kanë marrë vaksinën HPV.
Në kuadër të zhvillimit në fëmijërinë e hershme dhe edukimit të fëmijëve, shteti shqiptar ka vënë në funksion një sërë mekanizmash me fokus parësor përfshirjen e fëmijëve më të margjinalizuar.

Ndër rezultatet kryesore të arritura përmenden:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, si dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Parandalimin e Dhunës dhe Rritjen e Sigurisë në Shkolla.
- Janë zhvilluar manuale, module dhe broshura për drejtuesit e shkollave, mësuesit, nxënësit dhe prindërit.
- Është ngritur një sistem për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës dhe bullizmit në shkolla, i shoqëruar me fushata ndërgjegjësuese dhe miratimin e akteve ligjore për të parandaluar punësimin e mësuesve të dënuar për krime ndaj të miturve.
- Numri i oficerëve të sigurisë është rritur nga 150 në 220 në vitin 2022 dhe në 222 në vitin 2024, duke përfshirë shkollat 9-vjeçare me mbi 700 nxënës. Oficerët trajnohen dhe certifikohen nga Akademia e Sigurisë.
- Të gjitha shkollat mbulohen nga shërbimet psikosociale, me 595 zyra funksionale dhe raport 1 punonjës për 300–499 nxënës. Vetëm gjatë vitit shkollor 2023–2024 janë realizuar 16,891 aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit, 3,110 me mësuesit dhe 2,389 me prindërit.
- Gjatë vitit shkollor 2024–2025 janë hapur 270 klasa përgatitore me gjithsej 5,563 nxënës. Në total, 85% e fëmijëve që fillojnë klasën e parë kanë ndjekur kopshtin ose grupin përgatitor.

- Të gjithë edukatorët e arsimit parashkollor (100%) janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencash dhe metodologjisë së të nxënit me në qendër fëmijën, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Numri i mësuesve ndihmës ka arritur në 2,266, duke mbuluar 5,233 nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës.
- Janë ngritur 291 klasa burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe janë hartuar programe të posaçme arsimore dhe teknologjike për arsimin special. Gjithashtu, është forcuar mbështetja financiare dhe logjistike përmes transportit falas, teksteve falas dhe pajisjeve didaktike e teknologjike.
- Janë krijuar 1,245 rrjete profesionale të mësuesve, të trajnuara për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe praktika gjithëpërfshirëse. Në vitin 2024, 16,045 mësues kanë marrë trajnim për një modul dhe 7,046 për dy module.

Në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të "Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025", Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka zhvilluar një sërë trajnimesh dhe fushatash ndërgjegjësuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. AKSK është institucioni i parë i angazhuar në pilotimin e projektit global të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, në partneritet me UNICEF Shqipëri, "Krijimi i një mjedisi digjital të sigurt dhe fuqizues për fëmijët".

Megjithatë, analiza e raportit evidenton një sërë sfidash të vazhdueshme. Një ndër problematikat kryesore mbetet mungesa e raportimit të plotë dhe të standardizuar nga të gjitha institucionet, veçanërisht në nivel vendor, ku jo të gjitha bashkitë kanë raportuar mbi zbatimin e aktiviteteve dhe treguesve. Po ashtu, vazhdojnë të evidentohen mangësi në mbledhjen, analizimin dhe disagregimin e të dhënave për fëmijët, gjë që vështirëson monitorimin efektiv të politikave dhe planifikimin e bazuar në evidencë.

Sfida të tjera lidhen me:

- mungesën e linjave të dedikuara buxhetore për fëmijët në nivel qendror dhe vendor;
- nevojën për forcimin e koordinimit ndërsektorial ndërmjet arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe policisë;
- mbulimin e pamjaftueshëm me shërbime të specializuara në disa bashki;
- nevojën për harmonizim të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe acquis të BE-së;
- mungesën e standardeve dhe shërbimeve të specializuara për fëmijët e huaj të pashoqëruar;
- varësinë e konsiderueshme nga financimi i partnerëve ndërkombëtarë për një pjesë të shërbimeve dhe programeve për fëmijët.

Raporti nënvizon gjithashtu rëndësinë e forcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse dhe monitoruese, si dhe nevojën për investime të qëndrueshme në shërbime komunitare, programe të prindërimit pozitiv, sigurinë online dhe mbështetjen për grupet më vulnerabël të fëmijëve.

## I.3 Vizioni i strategjisë dhe qëllimet strategjike

### Vizioni i AKDF-së

> *"Çdo fëmijë në Shqipëri gëzon të drejta të plota dhe të barabarta, rritet në një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës, ka akses në shërbime cilësore dhe të integruara, mbrohet nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi, diskriminimi dhe përjashtimi social, si dhe fuqizohet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën familjare, komunitare dhe shoqërore, duke realizuar potencialin e tij të plotë në një shoqëri demokratike, të drejtë, të qëndrueshme dhe të harmonizuar me standardet evropiane të të drejtave të fëmijëve"*

Qëllimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 është të sigurojë një kuadër strategjik kombëtar, ndërsektorial dhe të orientuar drejt rezultateve, për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2023)[5], standardet e Bashkimit Evropian dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Shqipërisë.

Agjenda synon të konsolidojë dhe forcojë sistemin kombëtar të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve përmes:

a) garantimit të vazhdimësisë dhe përfundimit të reformave të nisura në kuadër të Agjendës 2021–2026;
b) adresimit të boshllëqeve sistemike dhe rreziqeve të reja që prekin fëmijët;
c) forcimit të koordinimit ndërinstitucional, llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në nivel qendror dhe vendor;
d) harmonizimit të politikave kombëtare për të drejtat e fëmijëve me prioritetet, standardet dhe iniciativat e Bashkimit Evropian;
e) forcimit të koherencës me strategjitë sektoriale dhe proceset kombëtare në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 strukturohet mbi tre qëllime strategjike kryesore:

(I) forcimin e qeverisjes qendrore dhe vendore për të garantuar një sistem të koordinuar dhe të financuar mirë, që mundëson respektimin, mbrojtjen, përmbushjen dhe monitorimin efektiv të të drejtave të fëmijëve.;
(II) eliminimin e të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktikave të dëmshme ndaj fëmijëve, përmes parandalimit, mbrojtjes efektive, drejtësisë miqësore dhe shërbimeve të integruara; si dhe
(III) promovimin e mirëqenies, zhvillimit gjithëpërfshirës dhe mundësive të barabarta për çdo fëmijë, përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale,

[5] https://www.ecoi.net/en/file/local/2098877/G2319930.pdf

mbrojtje sociale, transformim digjital dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike.

## Përfshirja e aktorëve dhe grupeve të interesit

### Konsultimet me përfaqësues të institucioneve qeveritare

Hartimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 u mbështet në një proces të gjerë konsultimi ndërinstitucional, me pjesëmarrjen aktive të institucioneve qendrore përgjegjëse për politikat dhe shërbimet që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Për koordinimin dhe drejtimin e procesit, me Urdhrin nr. 547, datë 05.11.2025, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030", u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës, i kryesuar nga Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe me përfaqësim të institucioneve kryesore përgjegjëse në fushën e të drejtave, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve.

Grupi Ndërinstitucional i Punës kishte mandat të udhëhiqte procesin e analizës së situatës, vlerësimit të progresit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, koordinimit ndërinstitucional, konsultimit me aktorët relevantë dhe hartimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, ndërsektoriale dhe të bazuar në të drejtat e fëmijëve.

Në përputhje me mandatet dhe përgjegjësitë e tyre institucionale, në proces morën pjesë:

- Ministria e Drejtësisë, për çështjet që lidhen me drejtësinë miqësore për fëmijët, drejtësinë për të miturit, mbrojtjen e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të veprave penale;
- Ministria e Arsimit, për arsimin gjithëpërfshirës, zhvillimin në fëmijërinë e hershme, sigurinë në shkolla dhe masat parandaluese;
- Ministria e Punëve të Brendshme, për sigurinë publike, migracionin, trafikimin dhe koordinimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve;
- Ministria e Financave, për integrimin e prioriteteve të Agjendës në planifikimin afatmesëm buxhetor, forcimin e praktikave të buxhetimit të ndjeshëm ndaj të drejtave dhe nevojave të fëmijëve, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare të masave;
- Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën kulturore, sportive dhe rekreative;
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, për aspektet që lidhen me inovacionin, transformimin digjital dhe aftësitë e së ardhmes;
- Instituti i Statistikave (INSTAT), për zhvillimin e treguesve, prodhimin e statistikave dhe forcimin e sistemit të monitorimit të të drejtave të fëmijëve;
- Avokati i Popullit, për mbikëqyrjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe standardeve të të drejtave të njeriut;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për promovimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të fëmijëve;

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), për mbrojtjen e fëmijëve në media dhe mjedisin audioviziv;
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), për sigurinë online, mbrojtjen nga reziqet kibernetike dhe promovimin e një mjedisi digjital të sigurt për fëmijët;
- Policia e Shtetit, për mbrojtjen e fëmijëve, parandalimin e trafikimit, trajtimin e rasteve të dhunës dhe drejtësinë për të miturit;
- Shërbimi Social Shtetëror, për koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Instituti i Shëndetit Publik, për politikat e shëndetit të fëmijëve, parandalimin, promovimin e shëndetit dhe mbështetjen me të dhëna epidemiologjike.
- Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor- për ofrimin e shërbimeve shëndetësore parësore dhe spitalore, duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme për të gjithë qytetarët
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës- për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës.

Përmes takimeve të rregullta të Grupit Ndërinstitucional të Punës, konsultimeve tematike dhe shkëmbimit të komenteve me shkrim, institucionet kontribuan në identifikimin e prioriteteve strategjike, formulimin e objektivave dhe masave të Agjendës, si dhe në harmonizimin e saj me strategjitë sektoriale kombëtare, procesin e integrimit evropian dhe rekomandimet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Ky proces siguroi një qasje të koordinuar ndërsektoriale dhe një ndarje të qartë të përgjegjësive për zbatimin e Agjendës në periudhën 2027–2030.

**Zëri i Fëmijëve për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030**

*Analizë e konsultimeve me fëmijët dhe adoleshentët*

Kjo analizë bazohet në konsultimet e zhvilluara me 74 fëmijë dhe adoleshentë (55 vajza dhe 19 djem), të moshës 13–18 vjeç, nga Tirana, Vora, Kukësi, Cërriku, si dhe me fëmijët që janë pjesë në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe organizata Alo Mik, në kuadër të procesit të hartimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030. Konsultimet u organizuan në grupe tematike dhe synuan të krijonin hapësira të sigurta, ku fëmijët të shprehnin lirshëm mendimet, shqetësimet dhe rekomandimet e tyre për politikat që ndikojnë drejtpërdrejt jetën dhe mirëqenien e tyre.

*Fëmijët kërkojnë të dëgjohen, jo vetëm të konsultohen*

Mesazhi më i fortë që doli nga të gjitha konsultimet ishte se fëmijët duan të jenë pjesë reale e vendimmarrjes. Ata nuk e konsiderojnë pjesëmarrjen thjesht si praninë në aktivitete apo konsultime sporadike, por si mundësinë për të ndikuar konkretisht në vendimet që prekin jetën e tyre. Shumë fëmijë ndanë perceptimin se mendimet e tyre dëgjohen vetëm formalisht dhe se vendimet vazhdojnë të merren kryesisht nga të rriturit. Në veçanti, fëmijët nga Kukësi dhe Cërriku evidentuan mungesën e hapësirave funksionale për pjesëmarrje dhe dobësinë e strukturave rinore ekzistuese. Nga ana

tjetër, edhe në Tiranë dhe Vorë, ku niveli i ndërgjegjësimit për të drejtat dhe pjesëmarrjen ishte më i lartë, fëmijët kërkuan më shumë mundësi për të ndikuar realisht në proceset vendimmarrëse.

Një nga mesazhet që përmbledh më mirë këtë kërkesë është:

> *"Mos na pyesni vetëm çfarë mendojmë; tregoni si mendimi ynë ndryshon diçka."*

Fëmijët propozuan mekanizma të rinj pjesëmarrjeje, përfshirë platforma digjitale, anketa online, forume rinore dhe forma anonime të shprehjes së mendimit, duke treguar se teknologjia mund të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për zgjerimin e pjesëmarrjes dhe përfshirjen e atyre që hezitojnë të flasin publikisht. Një element veçanërisht i rëndësishëm ishte kërkesa për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Fëmijët theksuan se mundësitë për t'u dëgjuar duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë, pavarësisht gjinisë, vendbanimit, statusit ekonomik, aftësive apo përkatësisë sociale. Për ta, një pjesëmarrje e vërtetë është ajo ku asnjë fëmijë nuk mbetet jashtë.

*Dhuna mbetet shqetësimi më i madh*

Tema e dytë që dominoi diskutimet ishte dhuna ndaj fëmijëve. Pothuajse në të gjitha grupet, fëmijët identifikuan dhunën si një problem të përditshëm që prek sigurinë, mirëqenien emocionale dhe zhvillimin e tyre. Bullizimi rezultoi forma më e përhapur e dhunës e raportuar nga fëmijët. Ata e përshkruan atë si një fenomen që ndodh në shkollë, në komunitet dhe gjithnjë e më shumë në mjedisin online. Sipas tyre, pasojat e bullizimit shkojnë përtej momentit të incidentit, duke ndikuar vetëvlerësimin, marrëdhëniet sociale, rezultatet në shkollë dhe shëndetin mendor. Një gjetje veçanërisht shqetësuese ishte se shumë fëmijë vazhdojnë të mos raportojnë rastet e dhunës. Frika nga paragjykimi, mungesa e besimit se situata do të ndryshojë dhe mosnjohja e mekanizmave të raportimit janë ndër arsyet kryesore të heshtjes së tyre.

Në diskutime u dëgjuan mesazhe të tilla si:

> *"Ndonjëherë është më e vështirë të kërkosh ndihmë sesa të përballosh problemin."*

> *"Kur raportojmë, duam të na besojnë dhe jo të na gjykojnë."*

Fëmijët nuk kërkuan vetëm masa ndëshkuese ndaj autorëve të dhunës. Përkundrazi, ata insistuan në nevojën për edukim mbi marrëdhëniet e shëndetshme, mbështetje emocionale, ndërhyrje parandaluese dhe krijimin e mjediseve ku raportimi të jetë i sigurt dhe pa pasoja negative për viktimën. Një nga mesazhet më domethënëse që doli nga konsultimet ishte se siguria emocionale është po aq e rëndësishme sa siguria fizike. Për fëmijët, mbrojtja nuk nënkupton vetëm mungesën e dhunës, por edhe praninë e mbështetjes, mirëkuptimit dhe besimit.

*Mbrojtja për fëmijët fillon me mbështetjen*

Gjatë konsultimeve, fëmijët e përkufizuan mbrojtjen si një koncept të lidhur ngushtë me sigurinë, ndjenjën e përkatësisë, mirëqenien emocionale dhe mundësinë për të marrë mbështetje në kohën e duhur. Ata theksuan se mbrojtja e fëmijëve nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve, por kërkon angazhimin e koordinuar të familjes, shkollës, komunitetit dhe shërbimeve publike. Shëndeti mendor

u identifikua si një nga temat më të rëndësishme dhe më të diskutuara gjatë procesit të konsultimit. Fëmijët e konsideruan mbështetjen psikologjike si një nevojë thelbësore për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre, e cila duhet të jetë e aksesueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe jo vetëm në situata krize. Në këtë kuadër, ata kërkuan rritjen e numrit të psikologëve, punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë mbështetës në shkolla dhe komunitete, si dhe ndërmarrjen e masave për reduktimin e stigmës dhe paragjykimeve që vazhdojnë të shoqërojnë problematikat e shëndetit mendor.Një citim që përmbledh këtë nevojë është:

*"Kur kemi një problem emocional, nuk duhet të ndihemi sikur jemi vetëm."*

Fëmijët kërkuan që institucionet të bashkëpunojnë më mirë mes tyre dhe të reagojnë në mënyrë të koordinuar ndaj nevojave të fëmijëve. Për ta, një sistem efektiv mbrojtjeje është ai ku ndihma është e aksesueshme, e shpejtë dhe e kuptueshme.

*Një shkollë që kujdeset për mirëqenien*

Konsultimet evidentuan gjithashtu pritshmëritë e fëmijëve për një shkollë që shkon përtej funksionit tradicional të transmetimit të njohurive akademike. Fëmijët e perceptojnë shkollën si një mjedis ku duhet të zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, të ndihen të sigurt, të mbështetur dhe të respektuar. Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish vlerësuan se sistemi arsimor mbetet i orientuar kryesisht drejt mësimdhënies teorike dhe shprehën nevojën për më shumë mundësi të të nxënit praktik dhe ndërveprues. Në këtë kuadër, u evidentua kërkesa për përmirësimin e infrastrukturës dhe mjeteve mësimore, përfshirë laboratorët, klasat digjitale, pajisjet shkencore dhe përdorimin e metodave më bashkëkohore dhe interaktive të mësimdhënies, veçanërisht nga fëmijët pjesëmarrës në Kukës dhe Vorë. Krahas cilësisë së arsimit, fëmijët ngritën shqetësime edhe për mirëqenien emocionale në mjedisin shkollor, duke kërkuar më shumë aktivitete sportive, kulturore dhe sociale, si dhe krijimin e hapësirave të sigurta ku të mund të shprehin mendimet, shqetësimet dhe sfidat me të cilat përballen në jetën e përditshme.Një mesazh që u përsërit në forma të ndryshme ishte:

*"Një shkollë e mirë nuk është vetëm ajo që na mëson, por ajo që kujdeset për ne."*

Fëmijët e lidhin drejtpërdrejt suksesin akademik me mirëqenien emocionale. Sipas tyre, një shkollë që nuk adreson stresin, ankthin, bullizimin apo vështirësitë emocionale nuk mund të garantojë zhvillimin e plotë të fëmijëve.

*Bota digjitale: mundësi dhe rrezik njëkohësisht*

Teknologjia dhe interneti janë pjesë e pandashme e jetës së fëmijëve dhe kjo u reflektua qartë në diskutime. Fëmijët e vlerësojnë internetin si një mjet për të mësuar, komunikuar dhe zhvilluar aftësi të reja. Megjithatë, ata treguan një ndërgjegjësim të lartë për rreziqet që lidhen me përdorimin e tij. Shqetësimet kryesore lidhen me bullizimin online, mashtrimet në internet, keqinformimin, cenimin e privatësisë dhe sigurinë e të dhënave personale. Fëmijët nuk kërkuan kufizimin e teknologjisë, por përdorimin e saj në mënyrë më të sigurt dhe më të mençur.

Një nga mesazhet e tyre ishte:

*“Na mësoni si të jemi të sigurt online, jo si të qëndrojmë larg internetit.”*

Veçanërisht në zonat jashtë Tiranës, fëmijët evidentuan nevojën për investime më të mëdha në infrastrukturën digjitale të shkollave, internet cilësor dhe pajisje teknologjike. Kjo tregon se për ta, qasja në teknologji dhe aftësitë digjitale janë pjesë e të drejtës për arsim cilësor dhe mundësi të barabarta.

*Çfarë Shqipërie duan fëmijët në vitin 2030?*

Në tërësi, konsultimet tregojnë se fëmijët kanë një vizion të qartë për të ardhmen. Ata duan një Shqipëri ku zëri i tyre dëgjohet dhe merret në konsideratë; ku shkollat janë të sigurta dhe mbështetëse; ku dhuna nuk tolerohet; ku shërbimet psikologjike janë të aksesueshme; dhe ku teknologjia përdoret për zhvillim dhe jo për përjashtim. Pesë prioritetet kryesore të identifikuara nga vetë fëmijët janë:

1. Pjesëmarrje reale dhe kuptimplotë në vendimmarrje.
2. Parandalim dhe adresim efektiv i të gjitha formave të dhunës.
3. Më shumë mbështetje psikosociale dhe mekanizma mbrojtës.
4. Arsim cilësor i lidhur me mirëqenien dhe zhvillimin personal.
5. Një mjedis digjital i sigurt, edukues dhe gjithëpërfshirës.

Mesazhi i përcjellë nga fëmijët gjatë procesit të konsultimit ishte nevoja për zbatimin efektiv të të drejtave të tyre në praktikë. Ata shprehën pritshmërinë që politikat, programet dhe shërbimet që i prekin drejtpërdrejt të jenë të aksesueshme, cilësore dhe të përgjigjen ndaj nevojave reale të fëmijëve. Konsultimet treguan se fëmijët e shohin veten jo vetëm si përfitues të politikave publike, por edhe si aktorë të rëndësishëm me të drejtë për t'u dëgjuar dhe për të kontribuar në proceset vendimmarrëse. Në këtë kontekst, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 ofron një mundësi të rëndësishme për të forcuar qasjen e bazuar në pjesëmarrjen e fëmijëve dhe për të siguruar që politikat dhe masat e ndërmarra të reflektojnë zërin, përvojat dhe prioritetet e tyre. Kjo qasje kontribuon në ndërtimin e politikave më efektive, më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të fëmijëve në Shqipëri.Mesazhi përmbyllës i fëmijëve për AKDF 2027-2030:

*“Duam të jetojmë në një Shqipëri ku ndihemi të dëgjuar, të sigurt, të mbështetur dhe të respektuar çdo ditë.”*

**Konsultimi me organizatat e shoqërisë civile**

Hartimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 është mbështetur në një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, shëndetësisë, përfshirjes sociale, drejtësisë, aftësisë së kufizuar, migracionit dhe fuqizimit të të rinjve. Organizatat e shoqërisë civile kanë kontribuar gjatë gjithë procesit të hartimit të Agjendës përmes pjesëmarrjes në grupet e punës tematike, takimet konsultative, diskutimet teknike dhe proceset e rishikimit të dokumentit. Kontributi i tyre ka ndihmuar në identifikimin e sfidave kryesore me të cilat përballen fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe në formulimin e objektivave, prioriteteve dhe masave të Agjendës.

Nëpërmjet përvojës së tyre në terren dhe punës së drejtpërdrejtë me fëmijët, familjet dhe komunitetet, organizatat e shoqërisë civile[6] kanë ofruar evidenca, analiza dhe rekomandime konkrete mbi funksionimin e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve, aksesin në shërbime, përfshirjen sociale, pjesëmarrjen e fëmijëve, sigurinë digjitale, drejtësinë miqësore për fëmijët dhe fusha të tjera prioritare të Agjendës. Një rol të rëndësishëm organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur edhe në mbështetjen e proceseve të konsultimit me vetë fëmijët. Përmes rrjeteve dhe programeve të tyre, ato kanë kontribuar në krijimin e hapësirave të sigurta për dëgjimin e zërit të fëmijëve dhe përfshirjen e rekomandimeve të tyre në hartimin e Agjendës, në përputhje me parimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

[6] Lista e organizatave të shoqërisë civile që kanë kontribuar në agjendë gjenden në shtojca 2.

# PJESA II. QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË KUADRIT STRATEGJIK

## Qëllimi strategjik I: Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore për të garantuar një sistem të mirë koordinuar dhe të financuar, që mundëson respektimin, mbrojtjen, përmbushjen dhe monitorimin efektiv të të drejtave të fëmijëve.

Qëllimi Strategjik I synon të forcojë sistemin e qeverisjes për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, duke siguruar koordinim efektiv ndërinstitucional, planifikim të bazuar në evidencë, monitorim të rregullt dhe financim të qëndrueshëm për politikat dhe programet që ndikojnë në jetën e fëmijëve. Ky qëllim reflekton angazhimin e shtetit për të garantuar respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, standardet evropiane dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Gjatë periudhës 2027–2030, do të ndërmerren masa për fuqizimin e mekanizmave kombëtarë dhe vendorë të koordinimit dhe llogaridhënies, përmirësimin e kapaciteteve institucionale të strukturave përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve, si dhe zhvillimin e sistemeve të integruara të të dhënave dhe statistikave për monitorimin e progresit. Në të njëjtën kohë, do të promovohet përdorimi i evidencës në hartimin dhe vlerësimin e politikave, do të forcohet raportimi mbi situatën e të drejtave të fëmijëve dhe do të mbështetet buxhetimi i ndjeshëm ndaj fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.

Një element i rëndësishëm i këtij qëllimi është edhe garantimi i pjesëmarrjes kuptimplotë të fëmijëve në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret në konsideratë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave që i prekin drejtpërdrejt.

**Objektivi specifik I.1: Fuqizimi i institucioneve dhe mekanizma në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët**

Objektivi Specifik I.1 ndërtohet mbi arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, si dhe mbi rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), procesin e integrimit evropian dhe gjetjet e raportit të monitorimit të Agjendës.

Një pjesë e masave përfaqësojnë vazhdimësi të drejtpërdrejtë të ndërhyrjeve të nisura gjatë periudhës 2021–2026. Këtu përfshihen fuqizimi i rolit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF), forcimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), përmirësimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave për fëmijët, monitorimi i zbatimit të politikave dhe forcimi i koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor. Raporti i monitorimit të AKDF 2021–2026 evidenton se, megjithëse kuadri ligjor dhe institucional është konsoliduar, sfidat kryesore lidhen me zbatimin efektiv, raportimin e rregullt, koordinimin ndërinstitucional dhe disponueshmërinë e të dhënave të disagreguara për fëmijët.

Një grup tjetër masash reflekton drejtpërdrejt rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Këto përfshijnë forcimin e mekanizmave kombëtarë të koordinimit, rritjen e kapaciteteve dhe burimeve të ASHDMF-së, zhvillimin e mekanizmave për monitorimin e rekomandimeve ndërkombëtare, përmirësimin e sistemit të statistikave për fëmijët, si dhe zhvillimin e metodologjive

për buxhetimin e ndjeshëm ndaj fëmijëve. CRC ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur që Shqipëria të forcojë koordinimin ndërsektorial, të sigurojë burime të mjaftueshme për institucionet përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve dhe të zhvillojë sisteme më efektive të mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

Masat që lidhen me raportimin periodik të Agjendës në KKDMF dhe Kuvend, përfshirjen e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies burojnë nga rekomandimet e Bashkimit Evropian në kuadër të Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", të cilat kërkojnë forcimin e monitorimit, transparencës dhe zbatimit të politikave për të drejtat e fëmijëve.

Një risi e Agjendës 2027–2030 është integrimi i të drejtave të fëmijëve në politikat për emergjencat civile, ndryshimet klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Kjo masë reflekton zhvillimet e fundit ndërkombëtare, përfshirë Komentin e Përgjithshëm nr. 26 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi të drejtat e fëmijëve dhe mjedisin, si dhe nevojën për të adresuar ndikimin disproporcional që krizat klimatike dhe fatkeqësitë natyrore kanë mbi fëmijët.

Po ashtu, masat për nxitjen e kërkimit shkencor në fushën e të drejtave të fëmijëve, bashkëpunimin me akademinë dhe institucionet kërkimore, si dhe promovimin e etikës profesionale në media dhe komunikimin publik mbi fëmijët, adresojnë boshllëqe të identifikuara gjatë zbatimit të Agjendës së mëparshme dhe synojnë të krijojnë një kulturë më të fortë të politikëbërjes së bazuar në evidencë dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve në hapësirën publike.

Në këtë mënyrë, Objektivi Specifik I.1 kombinon vazhdimësinë e reformave të nisura, adresimin e rekomandimeve ndërkombëtare dhe përgjigjen ndaj sfidave të reja që ndikojnë në jetën e fëmijëve, duke krijuar bazën institucionale dhe financiare për zbatimin efektiv të të gjithë Agjendës 2027–2030.

**Masat prioritare:**

I.1.1 Qeverisje ndër-sektoriale funksionale dhe llogaridhënie për zbatimin e politikave për fëmijët

I.1.2 Forcimi i sistemit kombëtar të të dhënave, statistikave dhe evidencës për fëmijët dhe adoleshentët

I.1.3. Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve

## Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve

Qëllimi Strategjik II synon të sigurojë që çdo fëmijë në Shqipëri të rritet në një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe mbështetës, i lirë nga të gjitha format e dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktikave të dëmshme. Ky qëllim fokusohet në forcimin e mekanizmave të parandalimit, identifikimit të hershëm, raportimit dhe reagimit efektiv ndaj çdo forme rreziku që cënon mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve.

Ai synon të fuqizojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve përmes koordinimit ndërinstitucional, rritjes së aksesit në shërbime cilësore dhe të specializuara, mbështetjes së familjeve dhe komuniteteve, si dhe promovimit të mjediseve të sigurta në familje, shkollë, komunitet dhe hapësirën digjitale. Në qendër të këtij qëllimi qëndron interesi më i lartë i fëmijës, garantimi i të drejtës së tij për mbrojtje

dhe krijimi i kushteve që çdo fëmijë të jetojë, të zhvillohet dhe të marrë pjesë në shoqëri pa frikë nga dhuna, diskriminimi apo përjashtimi.

**Objektivi specifik II.1: Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.**

Objektivi Specifik II.1 synon të forcojë qasjen parandaluese ndaj dhunës ndaj fëmijëve, duke kaluar nga një fokus kryesisht tek reagimi pas ndodhjes së rasteve, drejt promovimit të edukimit, ndërgjegjësimit, mbështetjes së familjeve, prindërimit pozitiv dhe krijimit të mjediseve të sigurta dhe mbështetëse për fëmijët.

Ky objektiv ndërtohet mbi progresin e arritur gjatë zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, e cila vendosi bazat për promovimin e prindërimit pozitiv, ndërgjegjësimin publik dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë, raportet e monitorimit treguan se dhuna ndaj fëmijëve vazhdon të mbetet e përhapur në familje, shkollë, komunitet dhe gjithnjë e më shumë në mjedisin digjital. Gjithashtu, u evidentua mungesa e të dhënave të rregullta mbi qëndrimet shoqërore ndaj dhunës, si dhe nevoja për ndërhyrje më të strukturuara për ndryshimin e normave sociale që justifikojnë përdorimin e dhunës si formë disiplinimi.

Për këtë arsye, një nga risitë e objektivit është realizimi i një studimi kombëtar për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave ndaj dhunës ndaj fëmijëve, i cili do të krijojë një bazë të rëndësishme evidencash për monitorimin e tendencave, vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve parandaluese dhe zhvillimin e politikave të bazuara në të dhëna.

- Një grup i rëndësishëm masash në kuadër të këtij objektivi reflekton rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili i ka rekomanduar Shqipërisë të forcojë më tej masat për parandalimin dhe adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe të investojë në ndërhyrje të qëndrueshme që promovojnë prindërimin pozitiv, rrisin ndërgjegjësimin dhe nxisin mjedise të sigurta dhe mbështetëse për fëmijët. Në këtë kuadër përfshihen masat që synojnë edukimin, informimin, mbështetjen e familjeve, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe promovimin e kulturës së mosdhunës.Në këtë kuadër përfshihen:

- plani kombëtar i komunikimit për ndryshimin e normave sociale;
- fushatat kombëtare dhe lokale të ndërgjegjësimit;
- përfshirja e mediave, liderëve komunitarë dhe figurave publike;
- promovimi i raportimit etik të çështjeve që lidhen me fëmijët;
- fushatat për parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në udhëtim dhe turizëm.

Prindërimi pozitiv përbën një tjetër shtyllë themelore të objektivit dhe është një nga fushat ku Agjenda 2027–2030 zgjeron ndjeshëm ndërhyrjet krahasuar me periudhën e mëparshme. Raportet e monitorimit dhe konsultimet me profesionistët evidentuan se shumë raste të dhunës ndaj fëmijëve lidhen me mungesën e njohurive prindërore, stresin ekonomik dhe social, konfliktet familjare dhe mungesën e mbështetjes për familjet. Për këtë arsye, masat për përditësimin e Udhëzuesit Kombëtar për Prindërimin Pozitiv, integrimin e prindërimit pozitiv në shërbimet shëndetësore, programet e edukimit për prindërit dhe këshillimin psikosocial për familjet synojnë të ndërhyjnë herët dhe të mbështesin familjet para se situatat të përshkallëzohen në dhunë. Kjo qasje është plotësisht në linjë

me rekomandimet e KKBDF-së dhe me Kornizën INSPIRE të OBSH-së për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve.

Një komponent tjetër i rëndësishëm është **parandalimi i dhunës në mjedisin shkollor**, i cili mbështetet në masat e parashikuara në Planin e Veprimit për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore. Një sërë masash të këtij objektivi janë vazhdimësi dhe zgjerim i reformave të nisura nga Ministria e Arsimit, duke përfshirë:

- forcimin e sigurisë në shkolla;
- rritjen e numrit të punonjësve të shërbimit psikosocial;
- trajnimin e mësuesve dhe profesionistëve;
- krijimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në shkolla;
- fuqizimin e rolit të vetë fëmijëve përmes iniciativave të udhëhequra nga bashkëmoshatarët;
- investimet në infrastrukturë që promovon mirëqenien, përfshirjen dhe sigurinë.

Një nga risitë më të rëndësishme të Agjendës 2027–2030 është kapitulli për sigurinë digjitale dhe parandalimin e dhunës online. Konsultimet me fëmijët, profesionistët dhe institucionet evidentuan rritjen e shqetësimeve lidhur me bullizmin kibernetik, manipulimin e fëmijëve për qëllime shfrytëzimi seksual (grooming), shfrytëzimin seksual online, ekspozimin ndaj përmbajtjeve të dëmshme dhe cenimin e privatësisë së fëmijëve në internet.

Kjo fushë përbën gjithashtu një prioritet të rëndësishëm në Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe në Rekomandimet Përmbyllëse të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023), i cili i rekomandoi Shqipërisë të forcojë masat për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital, të parandalojë dhe adresojë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual online, si dhe të garantojë sigurinë dhe privatësinë e fëmijëve në internet.

Për këtë arsye, Agjenda përfshin për herë të parë një paketë të plotë masash që adresojnë sigurinë e fëmijëve në mjedisin digjital, përmes:

- edukimit mbi sigurinë online në shkolla;
- programeve për prindërit;
- marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe ASHDMF-së;
- përditësimit të protokolleve të sigurisë në shkolla;
- krijimit të një rrjeti kombëtar mbështetës për raportimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës online;
- forcimit të aftësive digjitale të fëmijëve, familjeve dhe mësuesve.

Në tërësi, Objektivi Specifik II.1 përfaqëson shtyllën parandaluese të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Ai synon të ndikojë jo vetëm në sjelljet individuale, por edhe në normat sociale, praktikat familjare, kulturën shkollore dhe sigurinë e mjedisit digjital. Vlera e shtuar e këtij objektivi qëndron në faktin se ai kombinon ndërhyrjet tradicionale të ndërgjegjësimit me masa të reja të bazuara në evidencë, prindërim pozitiv, pjesëmarrje të fëmijëve dhe siguri digjitale, duke krijuar kushte që më pak fëmijë të ekspozohen ndaj dhunës dhe më shumë fëmijë të rriten në mjedise të sigurta, mbështetëse dhe mbrojtëse.

**Masat prioritare:**

II.1.1. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe ndryshimi i normave sociale që tolerojnë dhunën ndaj fëmijëve

II.1.2. Promovimi i prindërimit pozitiv dhe mbështetja e familjeve për rritjen e fëmijëve pa dhunë

II.1.3. Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve në mjedisin shkollor dhe promovimi i një kulture pozitive në shkolla

II.1.4. Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes edukimit mbi sigurinë digjitale, përdorimin e sigurt të internetit, parandalimin dhe raportimin e dhunës online, si dhe mbrojtjen e privatësisë dhe integritetit të tyre në mjedisin digjital

**Objektivi specifik II.2: Përmirësimi i kuadrit normativ si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje**

Objektivi Specifik II.2 synon forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve përmes përmirësimit të kuadrit normativ, rritjes së efektivitetit të mekanizmave të raportimit dhe referimit, si dhe garantimit të një reagimi të koordinuar dhe në kohë ndaj rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve. Ky objektiv përfaqëson shtyllën institucionale të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe synon të sigurojë që çdo rast i një fëmije në nevojë për mbrojtje të identifikohet, vlerësohet dhe trajtohet në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Masat e këtij objektivi ndërtohen mbi progresin e arritur gjatë zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 dhe reformës së nisur me Ligjin nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Gjatë kësaj periudhe u ngritën Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, grupet teknike ndërsektoriale, mekanizmat e referimit dhe strukturat përgjegjëse në nivel vendor. Megjithatë, raportet e monitorimit evidentuan dallime të konsiderueshme ndërmjet bashkive në kapacitetet, financimin dhe funksionimin e këtyre mekanizmave, si dhe nevojën për standardizimin e procedurave të menaxhimit të rastit, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe forcimin e monitorimit të cilësisë së ndërhyrjeve.

Një pjesë e rëndësishme e masave përfaqësojnë vazhdimësi të drejtpërdrejtë të reformës së mbrojtjes së fëmijëve, duke synuar konsolidimin e saj. Këtu përfshihen rishikimi i Ligjit nr.18/2017 në funksion të harmonizimit me ligjin e ri për shërbimet shoqërore, forcimi i Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve, përmirësimi i menaxhimit të rastit në Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale, funksionimi i Grupeve Teknike Ndërsektoriale, forcimi i Mekanizmave të Koordinuar të Referimit dhe monitorimi periodik i funksionimit të mekanizmave të mbrojtjes. Këto masa adresojnë drejtpërdrejt sfidat e evidentuara gjatë zbatimit të Agjendës së mëparshme dhe synojnë të garantojnë që sistemi të funksionojë në mënyrë më të qëndrueshme dhe të unifikuar në të gjithë territorin e vendit.

Një risi e rëndësishme e këtij objektivi është përfshirja e masave që lidhen me financimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor. Për herë të parë parashikohet në mënyrë eksplicite buxhetimi lokal për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe funksionet e menaxhimit të rastit. Kjo masë reflekton rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar që Shqipëria të sigurojë burime të mjaftueshme financiare, teknike dhe njerëzore për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe të garantojë funksionimin efektiv të tyre në nivel vendor.

Objektivi reflekton gjithashtu rekomandimet e CRC-së dhe të Bashkimit Evropian për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfshihen rishikimi i Kodit të Familjes, Kodit Penal, ligjit për të drejtat e fëmijëve, procedurave të riatdhesimit, si dhe hartimi i akteve të reja që adresojnë sfida të reja si abuzimi seksual online dhe largimi i materialeve të paligjshme në internet. Këto masa pasqyrojnë zhvillimet e fundit të acquis të

Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe shfrytëzimit.

Një tjetër element me vlerë të shtuar është forcimi i standardeve të mbrojtjes së fëmijëve (child safeguarding) në të gjitha institucionet publike dhe private që punojnë me fëmijë. Kjo masë është rezultat i mësimeve të nxjerra nga praktikat ndërkombëtare dhe nga rastet e evidentuara në sektorë të ndryshëm, ku nevoja për politika të brendshme të mbrojtjes së fëmijëve është bërë gjithnjë e më e dukshme. Për herë të parë, Agjenda synon zgjerimin sistematik të standardeve të safeguarding në sektorin publik, organizatat e shoqërisë civile, institucionet rezidenciale, sportive, kulturore dhe fetare.

Objektivi adreson gjithashtu nevojën për të përmirësuar aksesin e fëmijëve dhe qytetarëve në mekanizmat e raportimit. Raportet e monitorimit dhe konsultimet me fëmijët kanë treguar se shumë raste të dhunës vazhdojnë të mos raportohen për shkak të mungesës së informacionit, frikës nga stigmatizimi ose mungesës së mekanizmave të aksesueshëm. Për këtë arsye, Agjenda parashikon zgjerimin e linjave të ndihmës, kanaleve elektronike të raportimit, mekanizmave të emergjencës dhe fushatave të informimit, me fokus të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në institucione rezidenciale, fëmijët migrantë dhe grupet e tjera në situata vulnerabiliteti.

Një prioritet i rëndësishëm është forcimi i koordinimit ndërinstitucional. Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), përmirësimi i shkëmbimit të informacionit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, ngritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe standardizimi i mbledhjes së të dhënave synojnë të adresojnë një nga sfidat më të evidentuara gjatë viteve të fundit: fragmentimin e përgjigjes institucionale ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto masa janë gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian, i cili ka theksuar nevojën për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve dhe forcimin e zbatimit praktik të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve.

Një dimension i veçantë i objektivit lidhet me grupet e fëmijëve në situata të veçanta vulnerabiliteti, përfshirë fëmijët viktima ose viktima të mundshme të trafikimit, fëmijët migrantë, azilkërkuesit, fëmijët e pashoqëruar dhe fëmijët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit. Masat që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të ekipeve KRAT, profesionistëve të kufirit dhe migracionit, si dhe fuqizimin e shërbimeve të emergjencës për pritjen dhe akomodimin e përkohshëm, reflektojnë rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë dhe zhvillimet e viteve të fundit në fushën e migracionit dhe mbrojtjes së fëmijëve.

**Masat prioritare:**

II.2.1 Forcimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe acquis të Bashkimit Evropian

II.2.2. Forcimi i mekanizmave të raportimit të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe garantimi i aksesit të fëmijëve dhe qytetarëve në kanale të sigurta raportimi

II.2.3 Forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërsektorial, referimit dhe menaxhimit të rasteve për reagim efektiv dhe të koordinuar ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë mbrojtje

**Objektivi specifik II.3: Sigurimi i shërbimeve të integruara dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të të gjitha formave të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit**

Objektivi Specifik II.3 fokusohet në sigurimin e shërbimeve të integruara, të specializuara dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit dhe formave të tjera të cenimit të të drejtave të tyre. Nëse Objektivi II.1 synon parandalimin e dhunës dhe Objektivi II.2 forcimin e mekanizmave për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve, ky objektiv synon të garantojë që çdo fëmijë i identifikuar si viktimë të ketë akses në shërbimet e nevojshme për rikuperimin, mbrojtjen dhe integrimin e tij në familje dhe komunitet.

Masat e këtij objektivi ndërtohen mbi progresin e arritur gjatë zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 dhe procesit të deinstitucionalizimit të shërbimeve për fëmijët. Gjatë viteve të fundit janë zgjeruar mekanizmat e identifikimit dhe referimit të rasteve, megjithatë raportet e monitorimit evidentojnë se mbetet i kufizuar numri i shërbimeve të specializuara, veçanërisht për fëmijët viktima të abuzimit seksual, trafikimit, shfrytëzimit, fëmijët me trauma të rënda, fëmijët në situatë migratore dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Gjithashtu, janë evidentuar pabarazi territoriale në aksesin ndaj shërbimeve dhe mungesë e kapaciteteve të specializuara në nivel vendor.

Një pjesë e rëndësishme e masave përfaqësojnë vazhdimësi të reformave të nisura gjatë periudhës së mëparshme, veçanërisht në drejtim të zgjerimit të shërbimeve emergjente, shërbimeve të rehabilitimit dhe mbështetjes psikosociale për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Këtu përfshihen masat për sigurimin e akomodimit emergjent, ofrimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës dhe abuzimit, zhvillimin e planeve individuale të mbrojtjes dhe riintegrimit, si dhe forcimin e mbështetjes për familjet. Këto masa adresojnë drejtpërdrejt një nga gjetjet kryesore të monitorimit të Agjendës 2021–2026, sipas së cilës identifikimi i rasteve është përmirësuar, por kapacitetet për ofrimin e shërbimeve të specializuara nuk janë zhvilluar me të njëjtin ritëm.

Një risi e rëndësishme e këtij objektivi është fokusi i veçantë tek fëmijët viktima të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës. Kjo masë reflekton rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar që Shqipëria të sigurojë shërbime të specializuara, multidisiplinare dhe të bazuara në traumë për fëmijët viktima të dhunës seksuale, shfrytëzimit dhe trafikimit. Për herë të parë, Agjenda adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojën për zgjerimin e shërbimeve rehabilituese dhe mbështetjes psikosociale për këto kategori fëmijësh, duke kaluar nga ndërhyrjet e përgjithshme drejt shërbimeve më të specializuara.

Objektivi reflekton gjithashtu rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe të organizatave ndërkombëtare për forcimin e reagimit ndaj shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet dhe krimeve kibernetike kundër fëmijëve. Për këtë arsye, Agjenda përfshin për herë të parë një paketë të dedikuar masash që synojnë ngritjen e kapaciteteve të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit për hetimin e rasteve të abuzimit seksual online, përmirësimin e kapaciteteve të Laboratorit Shkencor të Policisë dhe zhvillimin e njohurive mbi evidencat digjitale, sigurinë kibernetike dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Këto masa adresojnë një fushë të re rreziku për fëmijët, e cila nuk ka qenë e zhvilluar në të njëjtën masë në Agjendën e mëparshme.

Një tjetër element me vlerë të shtuar është zhvillimi i programeve rehabilituese dhe riintegruese për fëmijët në konflikt me ligjin. Kjo masë lidhet me zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe me rekomandimet e CRC-së për promovimin e masave alternative, rehabilitimit dhe riintegrimit social të fëmijëve, duke shmangur qasjet ndëshkuese dhe institucionale. Përmes këtyre programeve synohet rikthimi i fëmijëve në arsim, forcimi i mbështetjes psikosociale dhe integrimi i tyre në komunitet.

Objektivi i kushton vëmendje të veçantë edhe fuqizimit të profesionistëve që ofrojnë shërbime për fëmijët. Trajnimet ndërsektoriale për profesionistët e mbrojtjes sociale, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë dhe sigurisë synojnë të krijojnë një qasje të përbashkët dhe të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Kjo reflekton një nga mësimet kryesore të viteve të fundit: cilësia e shërbimeve për fëmijët varet jo vetëm nga ekzistenca e tyre, por edhe nga aftësitë dhe kompetencat e profesionistëve që i ofrojnë ato.

Një komponent tjetër i rëndësishëm është mbështetja e familjeve. Përvoja e monitorimit ka treguar se rehabilitimi dhe riintegrimi i suksesshëm i fëmijëve nuk mund të arrihet pa adresuar faktorët që kanë çuar në cenimin e të drejtave të tyre. Për këtë arsye, Agjenda parashikon këshillim prindëror, mbështetje psikosociale, programe të fuqizimit ekonomik dhe zgjerimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël. Këto masa janë në përputhje me qasjen e Garancisë Evropiane për Fëmijët dhe synojnë të reduktojnë faktorët e rrezikut që lidhen me varfërinë, përjashtimin social dhe mungesën e mbështetjes familjare.

Një risi tjetër është adresimi i nevojave të grupeve të fëmijëve që shpesh mbeten të padukshëm në sistem, përfshirë fëmijët e paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, fëmijët në situatë migratore dhe fëmijët e pashoqëruar. Përmes masave që garantojnë akses në arsim, shëndetësi, shërbime psikosociale dhe ndihmë ligjore, Agjenda synon të sigurojë që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë sistemit të mbrojtjes për shkak të statusit të tij administrativ ose migrator.

**Masat prioritare:**

II.3.1. Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve të specializuara për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje

**Objektivi specifik II.4: Forcimi i drejtësisë miqësore për fëmijët dhe mbrojtja efektive e fëmijëve viktima, dëshmitarë ose në konflikt me ligjin nga riviktimizimi dhe trauma sekondare**

Objektivi Specifik II.4 synon forcimin e drejtësisë miqësore për fëmijët dhe garantimin e mbrojtjes efektive të fëmijëve viktima, dëshmitarë ose në konflikt me ligjin nga riviktimizimi dhe trauma sekondare gjatë ndërveprimit me sistemin e drejtësisë. Ky objektiv vendos në qendër interesin më të lartë të fëmijës dhe synon që procedurat ligjore, institucionet dhe profesionistët të përshtaten me nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, dhe jo e kundërta.

Masat e këtij objektivi ndërtohen mbi reformat e ndërmarra gjatë viteve të fundit, veçanërisht pas miratimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe forcimit gradual të mekanizmave të mbështetjes për fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë. Agjenda e mëparshme dhe procesi i monitorimit treguan përparime të rëndësishme në krijimin e kuadrit ligjor, por gjithashtu evidentuan sfida të vazhdueshme në zbatimin praktik të standardeve të drejtësisë miqësore për fëmijët, sidomos në drejtim të koordinimit ndërinstitucional, aksesit në shërbime mbështetëse, kapaciteteve profesionale dhe mbrojtjes së fëmijëve nga riviktimizimi gjatë procedurave hetimore dhe gjyqësore.

Një pjesë e rëndësishme e masave përfaqëson vazhdimësi të reformave të nisura në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe të strategjive sektoriale të drejtësisë. Këtu përfshihen rishikimi dhe harmonizimi i procedurave për intervistimin e fëmijëve, garantimi i pjesëmarrjes së tyre në proceset ligjore, aksesi në ndihmë juridike falas, forcimi i mekanizmave të referimit dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional. Këto masa synojnë të adresojnë boshllëqet e identifikuara gjatë monitorimit të reformës së drejtësisë, ku zbatimi praktik shpesh ka rezultuar i pabarabartë ndërmjet institucioneve dhe zonave të ndryshme të vendit.

Objektivi reflekton drejtpërdrejt rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar vazhdimisht që Shqipëria të sigurojë procedura të specializuara për fëmijët viktima, dëshmitarë dhe fëmijët në konflikt me ligjin, duke reduktuar ekspozimin e tyre ndaj traumës dhe duke garantuar mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit gjyqësor. Në këtë kuadër, Agjenda parashikon forcimin e mbështetjes psikologjike, mbrojtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit, si dhe përdorimin e teknikave të specializuara të intervistimit dhe komunikimit me fëmijët.

Një element i rëndësishëm i këtij objektivi lidhet me forcimin e kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë. Raportet e monitorimit dhe vlerësimet ndërkombëtare kanë evidentuar se cilësia e trajtimit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë varet në masë të madhe nga aftësitë dhe njohuritë e profesionistëve që ndërveprojnë me ta. Për këtë arsye, Agjenda parashikon programe të vazhdueshme trajnimi për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, avokatët, psikologët, punonjësit socialë dhe koordinatorët për viktimat, me fokus drejtësinë miqësore për fëmijët, qasjen e ndjeshme ndaj traumës, intervistimin e specializuar dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm është garantimi i aksesit të fëmijëve në ndihmë juridike falas dhe në informacion të kuptueshëm për procedurat ligjore. Konsultimet me fëmijët dhe monitorimi i sistemit kanë treguar se shumë fëmijë nuk i kuptojnë të drejtat e tyre apo procedurat në të cilat përfshihen. Për këtë arsye, Agjenda parashikon zhvillimin e materialeve informuese miqësore për fëmijët dhe forcimin e mekanizmave që garantojnë përfaqësim juridik të specializuar për çdo fëmijë viktimë, dëshmitar ose në konflikt me ligjin.

Objektivi adreson gjithashtu një nga shqetësimet kryesore të ngritura nga CRC, Komisioni Evropian dhe organizatat e specializuara ndërkombëtare: parandalimin e riviktimizimit dhe traumës sekondare. Fëmijët që janë viktima ose dëshmitarë të krimeve shpesh përballen me intervista të përsëritura, procedura të gjata dhe mungesë koordinimi ndërmjet institucioneve. Për këtë arsye, Agjenda parashikon standardizimin e procedurave të bashkëpunimit ndërmjet sistemit të drejtësisë, strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve mbështetëse, me synim reduktimin e ekspozimit të fëmijës ndaj përvojave traumatike gjatë procesit.

Një dimension i rëndësishëm i objektivit lidhet me fëmijët në konflikt me ligjin. Në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe standardet ndërkombëtare, Agjenda promovon përdorimin e masave alternative ndaj ndjekjes penale dhe dënimit, si dhe zhvillimin e programeve rehabilituese dhe riintegruese që mbështesin rikthimin e të miturve në arsim, formim profesional dhe jetë komunitare. Kjo qasje reflekton rekomandimet e CRC-së për të kufizuar përdorimin e masave ndëshkuese dhe për të forcuar rehabilitimin dhe riintegrimin social si qëllimin kryesor të sistemit të drejtësisë për të mitur.

Një risi e rëndësishme e kësaj Agjende është vendosja e fokusit jo vetëm tek procedurat gjyqësore, por edhe tek zbatimi i vendimeve që prekin të drejtat e fëmijëve. Për këtë arsye përfshihet forcimi i mekanizmave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me pensionin ushqimor, të drejtën e takimit dhe të drejta të tjera të fëmijëve, duke adresuar një problematikë të evidentuar shpesh nga institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile.

**Masat prioritare:**

II.4.1 Përmirësimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët në sistemin e drejtësisë

II.4.2 Rritja e kapaciteteve të profesionistëve për trajtimin e fëmijëve në sistemin e drejtësisë

II.4.3 Parandalimi i riviktimizimit dhe traumës sekondare gjatë procedurave ligjore

## Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike

**Objektivi specifik III.1: Forcimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit për të garantuar rritjen e fëmijëve në mjedise familjare të sigurta dhe mbështetëse**

Ky objektiv synon forcimin e sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimin e procesit të deinstitucionalizimit, me qëllim garantimin e së drejtës së çdo fëmije për t'u rritur në një mjedis familjar të sigurt, të qëndrueshëm dhe mbështetës. Ky objektiv mbështetet në parimin themelor të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, se familja përbën mjedisin më të përshtatshëm për rritjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës dhe se institucionalizimi duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për periudha sa më të shkurtra.

Ky objektiv përfaqëson vazhdimësinë e reformës së deinstitucionalizimit të nisur në Shqipëri gjatë viteve të fundit dhe të reflektuar në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021–2026, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Deinstitucionalizimin 2025-2027. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt transformimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, përfshirë reduktimin gradual të kujdesit institucional rezidencial, zhvillimin e familjeve kujdestare dhe forcimin e shërbimeve komunitare. Megjithatë, monitorimi i politikave dhe shërbimeve ka treguar se procesi mbetet i papërfunduar dhe se një numër i konsiderueshëm fëmijësh vazhdojnë të kenë nevojë për alternativa më cilësore dhe më të qëndrueshme të kujdesit.

Një nga prioritetet kryesore të këtij objektivi është zgjerimi i sistemit të familjeve kujdestare. Kjo masë përfaqëson një vazhdimësi të drejtpërdrejtë të reformave të nisura në periudhën e mëparshme dhe adreson një nga rekomandimet kryesore të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar vazhdimisht që Shqipëria të rrisë përdorimin e kujdesit familjar dhe të reduktojë varësinë nga kujdesi institucional. Rritja e numrit të familjeve kujdestare vullnetare dhe profesionale synon t'u ofrojë fëmijëve pa kujdes prindëror një mjedis më të afërt me familjen, më të qëndrueshëm emocionalisht dhe më të përshtatshëm për zhvillimin e tyre.

Objektivi i kushton rëndësi të veçantë edhe riintegrimit të fëmijëve në familjen biologjike, kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. Përvoja e viteve të fundit ka treguar se një pjesë e konsiderueshme e rasteve të ndarjes së fëmijëve nga familja lidhen me faktorë të tillë si varfëria, mungesa e shërbimeve mbështetëse, problematikat sociale ose mungesa e kapaciteteve prindërore. Për këtë arsye, Agjenda promovon zhvillimin e programeve të riintegrimit dhe të mbështetjes familjare, duke synuar që ndarja e fëmijës nga familja të mos jetë një zgjidhje afatgjatë, por një masë e përkohshme kur është e domosdoshme për mbrojtjen e tij.

Një risi e rëndësishme e këtij objektivi është fokusi tek të rinjtë që largohen nga sistemi i kujdesit alternativ. Raportet e monitorimit dhe praktikat ndërkombëtare kanë evidentuar se kalimi nga kujdesi alternativ drejt jetës së pavarur mbetet një nga periudhat më sfiduese për të rinjtë. Për këtë arsye, Agjenda parashikon zhvillimin e programeve të tranzicionit drejt pavarësisë, përfshirë mbështetjen për strehim, arsim, aftësim profesional dhe punësim. Kjo masë reflekton rekomandimet e CRC-së dhe të Bashkimit Evropian për të garantuar mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë që dalin nga kujdesi alternativ dhe për të parandaluar përjashtimin social, papunësinë dhe varfërinë.

Një tjetër mësim i nxjerrë nga monitorimi i politikave të mëparshme është se deinstitucionalizimi nuk mund të arrihet pa investuar në shërbime parandaluese dhe mbështetëse për familjet. Për këtë arsye, objektivi parashikon zgjerimin e shërbimeve që ndihmojnë familjet biologjike të përballojnë situatat e vështira dhe të ruajnë kujdesin për fëmijët e tyre. Kjo qasje është në përputhje me Garancinë Evropiane për Fëmijët dhe me rekomandimet e CRC-së, të cilat theksojnë se largimi i fëmijës nga familja duhet të shmanget sa herë që është e mundur dhe se mbështetja duhet të fokusohet fillimisht tek familja dhe komuniteti.

Objektivi adreson gjithashtu nevojat e fëmijëve me nevoja komplekse, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët viktima të dhunës, trafikimit dhe shfrytëzimit. Përvoja e viteve të fundit ka treguar se këto kategori fëmijësh kanë nevojë për forma më të specializuara të kujdesit dhe mbështetjes. Për këtë arsye, Agjenda parashikon zhvillimin e shërbimeve të specializuara të kujdesit alternativ, duke siguruar që procesi i deinstitucionalizimit të jetë gjithëpërfshirës dhe të mos lërë pas grupet më vulnerabël.

Një komponent thelbësor i objektivit është forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale. Raportet e monitorimit kanë evidentuar se cilësia e kujdesit alternativ dhe e procesit të deinstitucionalizimit varet në masë të madhe nga aftësitë profesionale të punonjësve socialë, specialistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe ofruesve të shërbimeve. Për këtë arsye, Agjenda parashikon investime të vazhdueshme në trajnimin dhe zhvillimin profesional të tyre, me fokus standardet e kujdesit alternativ, menaxhimin e rasteve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

**Masa prioritare:**

III.1.1 Zhvillimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit

**Objektivi specifik III.2: Garantimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët**

Objektivi Specifik III.2 synon të garantojë që çdo fëmijë në Shqipëri të ketë akses të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt, pavarësisht statusit social, vendbanimit, gjinisë, aftësisë së kufizuar apo formave të tjera të vulnerabilitetit. Ky objektiv mbështetet në parimin se arsimi nuk është vetëm një e drejtë themelore, por edhe një nga instrumentet më të rëndësishme për reduktimin e varfërisë, promovimin e barazisë së mundësive dhe mbrojtjen e fëmijëve nga përjashtimi social.

Masat e këtij objektivi ndërtohen mbi progresin e arritur gjatë zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, Strategjisë së Arsimit Parauniversitar dhe reformave të ndërmarra për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës. Monitorimi i periudhës së mëparshme evidentoi përmirësime në regjistrimin e fëmijëve në arsim dhe në zgjerimin e shërbimeve mbështetëse, por njëkohësisht identifikoi sfida të vazhdueshme lidhur me fëmijët jashtë shkolle, pabarazitë territoriale, përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mungesën e të dhënave të plota për kujdesin në fëmijërinë e hershme dhe nevojën për të forcuar sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve në mjedisin shkollor.

Një nga prioritetet kryesore të këtij objektivi është rritja e pjesëmarrjes në arsimin e hershëm dhe parashkollor. Kjo masë reflekton rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), Garancisë Evropiane për Fëmijët dhe Raporteve të Progresit të Bashkimit Evropian, të cilat theksojnë rëndësinë e investimit në fëmijërinë e hershme si bazë për suksesin arsimor dhe zhvillimin afatgjatë të fëmijëve. Për këtë arsye, Agjenda parashikon zgjerimin e aksesit në arsimin parashkollor,

veçanërisht për fëmijët në zonat rurale dhe komunitetet në situata vulnerabiliteti, si dhe forcimin e sistemit të të dhënave për çerdhet dhe shërbimet e kujdesit në fëmijërinë e hershme.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm është parandalimi i braktisjes shkollore dhe identifikimi i hershëm i fëmijëve në rrezik përjashtimi nga arsimi. Monitorimi i politikave të mëparshme ka treguar se faktorë të tillë si varfëria, migracioni, problematikat familjare, aftësia e kufizuar apo mungesa e mbështetjes sociale vazhdojnë të ndikojnë në vijueshmërinë shkollore. Për këtë arsye, Agjenda promovon mekanizma të hershëm identifikimi, bashkëpunim më të fortë ndërmjet shkollave, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimeve sociale, si dhe zgjerimin e programeve pas-shkollore si instrumente për mbajtjen e fëmijëve në sistemin arsimor.

Objektivi reflekton gjithashtu një nga prioritetet kryesore të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, CRC-së dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara: zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Masat për përmirësimin e aksesit fizik në shkolla, rritjen e numrit të mësuesve ndihmës, specialistëve mbështetës dhe zhvillimin e shërbimeve për fëmijët me nevoja specifike synojnë të garantojnë që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar dhe për të marrë pjesë në jetën shkollore. Në këtë kuadër, ngritja e një strukture kombëtare për neurodivergjencën përfaqëson një risi të rëndësishme të kësaj Agjende dhe adreson nevojën për politika dhe shërbime më të specializuara për fëmijët me profile të ndryshme zhvillimore.

Një element i rëndësishëm që del nga mësimet e periudhës së mëparshme është nevoja për ta parë shkollën jo vetëm si institucion arsimor, por edhe si hapësirë për zhvillimin social, emocional dhe qytetar të fëmijëve. Për këtë arsye, Agjenda promovon zgjerimin e modelit “Shkolla Qendër Komunitare”, partneritetet ndërmjet shkollave dhe komunitetit, si dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe rekreative. Këto masa synojnë të rrisin përfshirjen e fëmijëve, të forcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të kontribuojnë në parandalimin e bullizmit, dhunës dhe përjashtimit social.

Një tjetër komponent me rëndësi strategjike është promovimi i sigurisë dhe mirëqenies në shkolla. Konsultimet me fëmijët dhe raportet e monitorimit kanë evidentuar se siguria fizike dhe emocionale në mjedisin shkollor mbetet një shqetësim i rëndësishëm. Për këtë arsye, Agjenda parashikon forcimin e rolit të psikologëve, punonjësve socialë, mjekëve dhe infermierëve shkollorë, si dhe krijimin e një sistemi të standardizuar për raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës, bullizmit dhe incidenteve që cenojnë sigurinë e fëmijëve. Kjo përfaqëson një nga risitë më të rëndësishme të objektivit dhe adreson drejtpërdrejt nevojën për politika të bazuara në evidencë dhe ndërhyrje të hershme.

Objektivi përfshin gjithashtu zhvillimin e kompetencave për të ardhmen, në përputhje me prioritetet e Bashkimit Evropian dhe transformimin digjital të arsimit. Integrimi i aftësive digjitale në procesin mësimor dhe forcimi i kapaciteteve të mësuesve synojnë të përgatisin fëmijët për sfidat dhe mundësitë e shoqërisë digjitale, duke reduktuar pabarazitë në aksesin ndaj teknologjisë dhe aftësive të reja.

Një risi e veçantë e këtij objektivi është integrimi më i fortë i dimensionit të shëndetit dhe mirëqenies në mjedisin arsimor. Planet vendore për promovimin e shëndetit, parandalimin e obezitetit, përdorimit të duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike reflektojnë një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj rolit të shkollës në zhvillimin e fëmijëve dhe adresojnë shqetësime të identifikuara si në konsultimet me fëmijët ashtu edhe në politikat sektoriale.

**Masa prioritare:**

III.2.1 Garantimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët

### Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në shërbime cilësore shëndetësore dhe mirëqenie psikologjike

Objektivi Specifik III.3 synon të sigurojë që çdo fëmijë dhe adoleshent në Shqipëri të ketë akses të barabartë në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor fizik dhe mendor, duke promovuar zhvillimin e shëndetshëm, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre. Ky objektiv mbështetet në të drejtën e fëmijës për standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit, të garantuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, dhe reflekton prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë, Strategjisë Kombëtare për Shëndetin Mendor 2030 (në proces) dhe Garancisë Evropiane për Fëmijët.

Masat e këtij objektivi ndërtohen mbi progresin e arritur gjatë viteve të fundit në zgjerimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët, programet kombëtare të vaksinimit dhe depistimit, si dhe forcimin gradual të shërbimeve psikosociale në shkolla. Megjithatë, monitorimi i politikave dhe konsultimet me profesionistët kanë evidentuar se mbeten sfida të rëndësishme në aksesin ndaj shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, identifikimin e hershëm të problematikave zhvillimore dhe shëndetësore, si dhe në garantimin e mbështetjes së barabartë për fëmijët që jetojnë në zona rurale apo në situata vulnerabiliteti.

Një nga prioritetet kryesore të këtij objektivi është forcimi i investimit në vitet e para të jetës. Programet e vizitave në familje (home visiting), promovimi i ushqyerjes me gji dhe identifikimi i hershëm i nevojave shëndetësore, zhvillimore dhe sociale reflektojnë evidencat ndërkombëtare që tregojnë se ndërhyrjet në fëmijërinë e hershme kanë ndikimin më të madh në zhvillimin afatgjatë të fëmijëve. Këto masa janë gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar forcimin e shërbimeve parandaluese dhe mbështetëse për fëmijët e vegjël dhe familjet e tyre.

Një risi e rëndësishme e këtij objektivi është vendosja e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve si prioritet strategjik. Gjatë konsultimeve për hartimin e Agjendës, fëmijët dhe adoleshentët shprehën shqetësime të vazhdueshme lidhur me stresin, ankthin, presionin akademik, bullizmin, problemet emocionale dhe mungesën e mbështetjes psikologjike në disa mjedise shkollore. Shumë prej tyre theksuan se kanë nevojë për më shumë psikologë në shkolla, më shumë hapësira të sigurta për të folur dhe më shumë mbështetje për mirëqenien emocionale. Këto zëra janë reflektuar në masat që synojnë zgjerimin e shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet, rritjen e numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla, si dhe krijimin e mekanizmave për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme në rastet e problemeve të shëndetit mendor.

Objektivi adreson gjithashtu nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe nevoja specifike zhvillimore. Përmirësimi i aksesit në terapi zhvillimore, rehabilitim dhe shërbime mbështetëse reflekton rekomandimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke synuar reduktimin e pabarazive në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor.

Një pjesë e rëndësishme e objektivit fokusohet tek parandalimi dhe identifikimi i hershëm i problematikave shëndetësore. Programet kombëtare të depistimit të shikimit, skoliozës dhe shëndetit oral përfaqësojnë vazhdimësi të investimeve të nisura gjatë viteve të fundit dhe synojnë të sigurojnë

që problemet shëndetësore të identifikohen dhe trajtohen në kohë. Kjo qasje është në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe me prioritetet e sistemit shëndetësor për forcimin e shërbimeve parandaluese.

Objektivi promovon gjithashtu një qasje më të gjerë ndaj shëndetit, duke e lidhur atë me stilin e jetesës dhe mirëqenien e përditshme të fëmijëve. Programet për edukimin shëndetësor, ushqyerjen e shëndetshme, aktivitetin fizik dhe parandalimin e sjelljeve me rrezik adresojnë disa nga sfidat e identifikuara në vitet e fundit, përfshirë obezitetin, përdorimin e substancave, mungesën e aktivitetit fizik dhe zakonet jo të shëndetshme të jetesës. Edhe gjatë konsultimeve, fëmijët kërkuan më shumë aktivitete sportive, ambiente rekreative dhe mundësi për të kaluar kohën e lirë në mënyrë aktive dhe të sigurt.

Një element tjetër i rëndësishëm është forcimi i rolit të shkollës si mjedis promovues i shëndetit. Përmes bashkëpunimit ndërmjet sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, Agjenda synon të krijojë mekanizma më efektivë për edukimin shëndetësor, mbështetjen psikosociale dhe referimin e hershëm të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime të specializuara.

**Masa prioritare:**

III.3.1 Forcimi i shërbimeve të shëndetit fizik dhe mendor për fëmijët dhe adoleshentët

**Objektivi specifik III.4: Transformimi digjital dhe përdorimi etik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të të drejtave të fëmijëve dhe mirëqënies së tyre**

Ky objektiv synon të garantojë që transformimi digjital dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjive të reja, përfshirë inteligjencën artificiale, të përdoren në mënyrë të sigurt, etike dhe gjithëpërfshirëse në funksion të zhvillimit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve. Ky objektiv reflekton një nga ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur në jetën e fëmijëve gjatë dekadës së fundit, ku teknologjia është bërë pjesë integrale e arsimit, komunikimit, informacionit dhe pjesëmarrjes sociale.

Ndryshe nga Agjenda e mëparshme, e cila fokusohej kryesisht në sigurinë online dhe aksesin në teknologji, kjo Agjendë zgjeron ndjeshëm qasjen duke adresuar njëkohësisht infrastrukturën digjitale, aftësitë digjitale, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mjedisin online dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në arsim. Kjo qasje reflekton zhvillimet e fundit në nivel evropian dhe ndërkombëtar, përfshirë Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijës, Dekadën Digjitale Evropiane 2030 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Arsimin Digjital 2025–2030.

Objektivi ndërtohet mbi mësimet e nxjerra nga periudha e mëparshme, ku investimet në teknologji dhe mësim online evidentuan njëkohësisht potencialin e madh të transformimit digjital dhe pabarazitë ekzistuese në akses. Monitorimi i politikave sektoriale tregoi se jo të gjithë fëmijët përfitojnë në mënyrë të barabartë nga teknologjia, veçanërisht fëmijët që jetojnë në zona rurale, familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet në situata vulnerabiliteti. Për këtë arsye, një shtyllë e rëndësishme e objektivit lidhet me investimet në infrastrukturën digjitale të arsimit, përmes zgjerimit të aksesit në internet broadband, laboratorëve inteligjentë (Smart Labs), tabelave interaktive dhe pajisjeve digjitale për mësuesit.

Një prioritet i rëndësishëm i objektivit është zhvillimi i kompetencave digjitale të fëmijëve dhe të rinjve. Konsultimet me fëmijët gjatë hartimit të Agjendës treguan se teknologjia konsiderohet nga vetë ata si një mjet i rëndësishëm për të mësuar, komunikuar dhe ndërtuar të ardhmen e tyre profesionale. Në të njëjtën kohë, fëmijët shprehën nevojën për më shumë njohuri dhe mbështetje për

të përdorur internetin në mënyrë të sigurt dhe për të kuptuar më mirë rreziqet që lidhen me mjedisin digjital. Këto shqetësime janë reflektuar në masat që promovojnë edukimin digjital, sigurinë online dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

Një nga risitë më të rëndësishme të kësaj Agjende është përfshirja e inteligjencës artificiale si komponent i politikave për fëmijët. Për herë të parë parashikohen masa që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin mësimor, zhvillimin e platformave të personalizuara të të nxënit, integrimin e njohurive mbi inteligjencën artificiale në kurrikulën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), si dhe hartimin e udhëzimeve kombëtare për përdorimin etik dhe të sigurt të inteligjencës artificiale në arsim. Këto masa synojnë të përgatisin fëmijët për një treg pune dhe një shoqëri që po transformohet me shpejtësi nga teknologjitë e reja.

Objektivi reflekton gjithashtu rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), i cili ka kërkuar që shtetet të marrin masa për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mjedisin digjital. Për këtë arsye, Agjenda parashikon programe ndërgjegjësimi për sigurinë online, mbrojtjen e privatësisë, përdorimin etik të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, si dhe aktivitete të dedikuara për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve në përputhje me legjislacionin e ri kombëtar dhe standardet evropiane.

Një komponent tjetër i rëndësishëm është mbështetja për prindërit dhe mësuesit. Përvoja e viteve të fundit ka treguar se siguria dhe mirëqenia e fëmijëve në internet nuk mund të garantohen vetëm përmes aftësive të fëmijëve, por kërkojnë edhe rritjen e kapaciteteve të të rriturve që i mbështesin ata. Për këtë arsye, objektivi përfshin programe edukative dhe ndërgjegjësuese për prindërit dhe mësuesit, me fokus përdorimin e sigurt të teknologjisë, mbrojtjen e privatësisë dhe identifikimin e rreziqeve online. Ky objektiv lidhet ngushtë edhe me prioritetet e tjera të Agjendës, veçanërisht ato që lidhen me sigurinë digjitale, mbrojtjen nga dhuna online, edukimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve. Ai kontribuon në krijimin e një mjedisi ku teknologjia nuk shihet vetëm si infrastrukturë apo mjet mësimor, por si një komponent i rëndësishëm i realizimit të të drejtave të fëmijëve në shekullin XXI.

**Masa prioritare:**

III.4.1 Përmirësimi i infrastrukturës digjitale në arsim për akses të barabartë të fëmijëve në teknologji

III.4.2 Integrimi i teknologjive inovative dhe inteligjencës artificiale në arsim

# PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

## III.1 Zbatimi i AKDF-së

Zbatimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 do të udhëhiqet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, në cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për politikat në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes sociale dhe familjes, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, e cila do të bashkërendojë aspektet teknike, monitoruese dhe koordinuese të Agjendës.

Një rol qendror në drejtimin strategjik, koordinimin ndërinstitucional dhe monitorimin e zbatimit të Agjendës do të ketë Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF), si mekanizmi më i lartë ndërsektorial për koordinimin e politikave për fëmijët, promovimin e dialogut ndërinstitucional dhe ndjekjen e progresit në zbatimin e angazhimeve kombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Zbatimi i Agjendës kërkon një qasje të integruar dhe ndërsektoriale, duke përfshirë institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me mandatet e tyre në fushën e të drejtave, mbrojtjes, zhvillimit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve. Në nivel qendror, institucionet kryesore përgjegjëse përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Mjedisit, Institutin e Statistikave, Shërbimin Social Shtetëror, Institutin e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit, si dhe institucionet e pavarura dhe rregullatore me rol në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përfshirë Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Një rol thelbësor në zbatimin e Agjendës do të kenë njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke qenë strukturat kryesore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale, arsimit parashkollor dhe komunitar, si dhe për koordinimin e mekanizmave vendorë të mbrojtjes së fëmijëve.

Agjenda do të mbështetet gjithashtu në bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, ofruesit e shërbimeve, organizatat komunitare, akademinë, profesionistët e fushës dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Fëmijët dhe adoleshentët do të përfshihen si mbajtës të të drejtave përmes mekanizmave të sigurt, etikë dhe të përshtatur sipas moshës për pjesëmarrje dhe konsultim, duke garantuar që zëri dhe perspektivat e tyre të reflektohen në mënyrë kuptimplotë në proceset e politikëbërjes, monitorimit dhe vlerësimit të Agjendës.

Partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht Bashkimi Evropian, UNICEF dhe agjenci të tjera ndërkombëtare, do të mbështesin zbatimin e Agjendës përmes asistencës teknike, mbështetjes institucionale, forcimit të kapaciteteve dhe harmonizimit të politikave kombëtare me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve.

## III.2 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 do të mbështetet në një sistem të integruar monitorimi, raportimi dhe vlerësimi, i cili synon të sigurojë ndjekjen e vazhdueshme të progresit, matjen e rezultateve dhe përmirësimin e politikave dhe shërbimeve për fëmijët bazuar në evidencë. Sistemi do të fokusohet jo vetëm në realizimin e aktiviteteve dhe masave të planifikuara, por edhe në vlerësimin e ndryshimeve konkrete në jetën e fëmijëve dhe në respektimin e të drejtave të tyre. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në rolin e institucionit koordinues të Agjendës, do të udhëheqë procesin e monitorimit dhe raportimit në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse, institucionet qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, partnerët e zhvillimit dhe vetë fëmijët.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave do të raportojnë në mënyrë periodike mbi progresin e treguesve, realizimin e aktiviteteve dhe përdorimin e burimeve financiare, përmes pikave fokale të përcaktuara në secilin institucion. Raportimi do të realizohet çdo vit dhe do t’i përcillet ASHDMF-së për analizë dhe konsolidim. Në funksion të rritjes së llogaridhënies dhe koordinimit ndërinstitucional, të dhënat do të mblidhen përmes sistemeve ekzistuese sektoriale të informacionit, regjistrave administrativë dhe mekanizmave të raportimit të institucioneve përgjegjëse.

Për monitorimin e zbatimit të Agjendës do të përdoren të dhëna administrative, statistika kombëtare, sisteme elektronike të menaxhimit të rasteve dhe shërbimeve, si dhe informacion i mbledhur nga strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijëve. Në mënyrë periodike do të merren në konsideratë edhe gjetjet e studimeve, vlerësimeve, raporteve të institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Një element i rëndësishëm i monitorimit do të jetë përfshirja e fëmijëve në vlerësimin e progresit të Agjendës. Përmes konsultimeve periodike, forumeve të fëmijëve, anketimeve dhe mekanizmave të tjerë të pjesëmarrjes, do të sigurohet që zëri dhe përvojat e fëmijëve të kontribuojnë në identifikimin e sfidave dhe përmirësimin e ndërhyrjeve. Gjetjet dhe rekomandimet e fëmijëve do të integrohen në proceset e monitorimit dhe raportimit si pjesë e vlerësimit të progresit të Agjendës.

Raporti Kombëtar i Progresit do të hartohet çdo vit nga ASHDMF dhe do t'i paraqitet Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe institucioneve të tjera përkatëse. Raporti do të analizojë nivelin e realizimit të objektivave dhe treguesve, sfidat e hasura gjatë zbatimit, faktorët që ndikojnë progresin dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve.

Për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien publike, raportet periodike dhe raportet vjetore të progresit do të publikohen dhe do të diskutohen me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, partnerët e zhvillimit dhe grupet e fëmijëve.

## III.3 Vlerësimi

Në kuadër të zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030 do të realizohen dy vlerësime të pavarura. Një vlerësim afatmesëm do të zhvillohet në vitin 2028 për të analizuar progresin e arritur gjatë gjysmës së parë të periudhës së zbatimit, për të identifikuar sfidat dhe për të propozuar masa korrigjuese sipas nevojës. Një vlerësim përfundimtar do të realizohet në vitin 2030 për të matur rezultatet, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve të Agjendës. Vlerësimet do të analizojnë jo vetëm nivelin e realizimit të aktiviteteve dhe treguesve, por edhe ndikimin e politikave dhe shërbimeve në përmirësimin e mirëqenies, mbrojtjes, pjesëmarrjes dhe përfshirjes së fëmijëve. Procesi i vlerësimit do të përfshijë konsultime me institucionet përgjegjëse, organizatat e shoqërisë civile, partnerët e zhvillimit, profesionistët e vijës së parë dhe vetë fëmijët. Gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimeve do të përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe programeve për fëmijët, si dhe për hartimin e strategjive dhe planeve të ardhshme kombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve.

# PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve për zbatimin e *Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030.* Kostimi i Planit është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostove indikative mbështetur në Qëllimet, Masat, treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në produktet e identifikuara për secilin aktivitet. Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (faza e II), të të gjitha ministrive që kanë masa në këtë plan, dhe institucionet e varësisë që janë përfshirë në zbatimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2027-2030, si dhe në kostot e strtegjive të tjera të listuara në këtë dokument, dhe anë ndihmuar për hartimin e aktiviteve. Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet të detajuar dhe ato janë klasifikuar sipas kategorive të paracaktuara të shpenzimev[7].

Metodologjia e përdorur për kostimin dhe ndarjen e tyre bazohet në një strukturë të qartë klasifikimi, e cila parashikon ndarjen e shpenzimeve në kategoritë e mëposhtme:

- ✓ Paga dhe sigurime shoqërore;
- ✓ Shpenzime operative;
- ✓ Trajnime, studime, asistenca teknike, etj.;
- ✓ Investime.

Ky klasifikim mundëson një paraqitje të qartë dhe të strukturuar të kostove, duke lehtësuar analizën, planifikimin dhe monitorimin e tyre. Përllogaritjet janë realizuar sipas viteve financiare, duke

[7] Në rastet ku ka patur hapësirë dhe shkojnë në një linjë me produktet e buxhetore, janë vendosur edhe produktet në tabelet e detajuara

paraqitur një shpërndarje të qartë të fondeve/për aktivitet/për objektiv/për qëllim, për secilën fushë përkatëse.

Kostoja totale për zbatimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2027-2030, është vlerësuar në një vlerë prej **1 991 999 171 (Një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një.) lekë.**

E cila shpërndahet si më poshtë:

- ✓ 1 289 798 262 **(Një miliard e dyqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë**, të vlerësuar kontribut nga Buxheti i Shtetit;
- ✓ **330,996,000 (Treqind e tridhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë,** të parashikuar për t'u siguruara nga donator/financim i huaj;
- ✓ 371,204,909 **(Treqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e katër mijë e nëntëqind e nëntë**. **lekë**, *hendek financiar*, i cili mund të mbulohet përmes:
  - rishikimit dhe prioritizimit të masave brenda tavaneve të Programit Buxhetor Afatmesëm gjatë cikleve të ardhshme buxhetore;
  - mobilizimit të fondeve nga instrumentet e asistencës së huaj, nëpërmjet organizateve të UN,WHO, etj, përfshirë edhe programet e Bashkimit Evropian (si p.sh. IPA) dhe projekte të tjera të financuara nga partnerët zhvillimorë ndërombëtarë. Programimi i këtyre fondeve realizohet në përputhje me ciklet shumëvjeçare të planifikimit dhe kuadrot përkatëse të bashkëpunimit (marrëveshje/memorandume mirëkuptimi), mbi bazën e prioriteteve të dakordësuara me palën shqiptare. Në këtë kontekst, angazhimet buxhetore reflektohen në mënyrë të fazuar në periudhat pasuese, duke integruar gradualisht edhe nevojat e pambuluara të identifikuara në kuadër të Agjendës;
  - zgjerimit të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare dhe donatorë bilateralë për financimin e ndërhyrjeve specifike; si dhe shfrytëzimit të skemave të bashkëfinancimit dhe mekanizmave të tjerë financiarë, aty ku është e aplikueshme.

Tabela e mëposhtme, pasqyron në detaje kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë periudhës 2027-2030, për secilën fushë, në Lekë dhe në Euro me një kurs mesatar për referencë është përllogaritur me 96 lek për 1 euro.

| | QËLLIMET | Kosto Totale | Kosto nga Buxheti i Shtetit | Financim i huaj | Hendeku financiar |
|---|---|---|---|---|---|
| I | Qëllimi strategjik Forcimi i qeverisjes qëndrore dhe vendore dhe ndër-sektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve | 59,094,091 | 40,334,091 | 8,800,000 | 9,960,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| II | Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve | 716,841,964 | 582,791,055 | 48,336,000 | 85,714,909 |
| III | Qëllimi strategjik III:Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën | 1,216,063,116 | 666,673,116 | 273,860,000 | 275,530,000 |
| | **TOTALI NË LEKË** | 1,991,999,171 | 1,289,798,262 | 330,996,000 | 371,204,909 |
| | **TOTALI NË EURO** | 20,749,991 | 13,435,399 | 3,447,875 | 3,866,718 |
| | **1 euro =96 Lekë** | | | | |

Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje ndarjen e burimeve financiare në % të të gjithë Planit të Veprimit 2026-2030 për AKDF.




Grafiku më poshtë jep detajet e burimeve të financimit për çdo fushë specifike.




Më poshtë është prezantuar tabela përmbledhëse dhe gjithë buxhetet e detajuara për çdo fushë në format exel.

## Tabela 1: Kosto indikative e Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, sipas qëllimeve, objektivave dhe masave

| QELLIMET | AFATI ZBATIMIT | | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | | VITET | | | | Kosto indikative (në 000/ ALL) | Burimi i mbulimit (në 000/ ALL) | | | Burimi i mbulimit (në EURO) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AFATI I FILLIMIT | AFATI I MBARIMIT | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONE T KONTRIBUESE | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 | | Buxhet Shtetit (000/ALL) | Financim i Huaj (000/ALL) | Hendeku financiar (në 000/ ALL) | Kosto indikative (në EURO) | Buxhet Shtetit (EURO) | Financim i Huaj (EURO) | Hendeku financiar (EURO) |
| **TOTALI** | | | | | **509,841** | **509,930** | **496,244** | **475,985** | **1,991,999** | **1,289,798** | **330,996** | **371,205** | **20,749,991** | **13,435,399** | **3,447,875** | **3,866,718** |
| I. Qëllimi strategjik Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore për të garantuar një sistem të mirë koordinuar dhe të financuar, që mundëson respektimin, mbrojtjen, përmbushjen dhe monitorimin efektiv të të drejtave të fëmijëve. | 2027 | 2030 | - | - | 10,373 | 21,000 | 17,569 | 10,152 | 59,094 | 40,334 | 8,800 | 9,960 | 615,563 | 420,147 | 91,667 | 103,750 |
| Objektivi I.1: Fuqizimi i institucioneve dhe mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët | 2027 | 2030 | - | - | 10,373 | 21,000 | 17,569 | 10,152 | 59,094 | 40,334 | 8,800 | 9,960 | 615,563 | 420,147 | 91,667 | 103,750 |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa prioritare I.1.1 Qeverisje ndër-sektoriale funksionale dhe llogaridhënie për zbatimin e politikave për fëmijët | 2027 | 2030 | MSHMS, ASHDMF MEPJ, AO, KMD, KDIMDHP, MF, ASPA, NJVV, AKMC, AKKSHTI, MA, AMA | ASHDMF, Ministritë e linjës, institucionet e tjera pjesë e KKDMF-së, ASHSPKN, ISHP, Universitetet, institucionet kërkimore, INSTAT, AMSHC, Institucionet publike, OJF | 5,830 | 15,232 | 11,942 | 5,950 | 38,953 | 34,043 | 3,600 | 1,310 | 405,762 | 354,616 | 37,500 | 13,646 |
| Masa prioritare I.1.2 Forcimi i sistemit kombëtar të të dhënave, statistikave dhe evidencës për fëmijët dhe adoleshentët | 2027 | 2030 | INSTAT, MSHMS, SHSSH | Minsitritë e Linjës, NJVV | 1,002 | 2,227 | 2,427 | 1,002 | 6,659 | 4,009 | - | 2,650 | 69,366 | 41,761 | - | 27,604 |
| Masa prioritare:I.1.3. Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve | 2027 | 2030 | MA, MSHMS, Bashkitë | Partnerë, AKAP, DRAP, ZVAP, NJVV, OJF | 3,541 | 3,541 | 3,200 | 3,200 | 13,482 | 2,282 | 5,200 | 6,000 | 140,436 | 23,769 | 54,167 | 62,500 |
| Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve | 2027 | 2030 | - | - | 196,970 | 188,351 | 174,161 | 157,360 | 716,842 | 582,791 | 48,336 | 85,715 | 7,467,104 | 6,070,740 | 503,500 | 892,864 |
| Objektivi specifik II.1: Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv. | 2027 | 2030 | - | - | 163,538 | 165,525 | 153,347 | 138,529 | 620,939 | 516,679 | 38,200 | 66,060 | 6,468,110 | 5,382,068 | 397,917 | 688,125 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa II.1.1. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe ndryshimi i normave sociale që tolerojnë dhunën ndaj fëmijëve | 2027 | 2030 | ASHDMF, MSHMS, AMA, MTKS | NJVV-të, OJF-të, MKR, AMA, KRAT, IPSH, OSHKSH, AP | 7,284 | 8,875 | 2,255 | 9,255 | 27,669 | 5,909 | 11,640 | 10,120 | 288,220 | 61,553 | 121,250 | 105,417 |
| Masa II.1.2. Promovimi i prindërimit pozitiv dhe mbështetja e familjeve për rritjen e fëmijëve pa dhunë. | 2027 | 2030 | ASHDMF, MSHMS, MA, NJVV-të | NJVV-të, OJF-të, MKR, AMA, KRAT, AP | 4,862 | 5,299 | 4,041 | 4,041 | 18,243 | 8,883 | 5,720 | 3,640 | 190,032 | 92,532 | 59,583 | 37,917 |
| Masa II.1.3. Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve në mjedisin shkollor dhe promovimi i një kulture pozitive në shkolla. | 2027 | 2030 | ZVA, ASHDMF, NJVV, MA, MPB, ASCAP | NJVV-të, OJF-të, ZVA, Partner | 125,473 | 125,773 | 121,473 | 121,473 | 494,191 | 434,891 | 16,450 | 42,850 | 5,147,822 | 4,530,114 | 171,354 | 446,354 |
| Masa II.1.4. Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes edukimit mbi sigurinë digjitale, përdorimin e sigurt të internetit, parandalimin dhe raportimin e dhunës online, si dhe mbrojtjen e privatësisë dhe integritetit të tyre në mjedisin digjital | 2027 | 2030 | MA, ASHDM, ASCAP, NJVV, AKSK, Policia e Shtetit | MSHMS, NJVV, Partner | 25,919 | 25,578 | 25,578 | 3,760 | 80,835 | 66,995 | 4,390 | 9,450 | 842,036 | 697,869 | 45,729 | 98,438 |
| Objektivi specifik II.2: Përmirësimi i kuadrit normativ si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje | 2027 | 2030 | - | - | 22,388 | 11,800 | 10,809 | 9,645 | 54,642 | 39,461 | 6,630 | 8,551 | 569,183 | 411,049 | 69,063 | 89,072 |
| Masa II.2.1 Forcimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe acquis të Bashkimit Evropian | 2027 | 2030 | MD, MPB, MSHMS, SHSSH, ASHDMF, AMVV, NJVV | Partner, MSHMS, ASHDMF, ASHDMF, MA, NJVV, OJF | 12,387 | 1,799 | 1,369 | 205 | 15,759 | 13,139 | 630 | 1,990 | 164,161 | 136,869 | 6,563 | 20,729 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa II.2.2. Forcimi i mekanizmave të raportimit të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe garantimi i aksesit të fëmijëve dhe qytetarëve në kanale të sigurta raportimi | 2027 | 2030 | MSHMS, ASHDMF, MA, MPB | NJVV, OJF-të, ON, Policia e Shtetit | 2,350 | 2,350 | 2,150 | 2,150 | 9,000 | 800 | 2,000 | 6,200 | 93,750 | 8,333 | 20,833 | 64,583 |
| Masa II.2.3 Forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërsektorial, referimit dhe menaxhimit të rasteve për reagim efektiv dhe të koordinuar ndaj rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (të fëmijëve në nevojë mbrojtje) | 2027 | 2030 | MSHMS, ASHDMF, OSHC, SHSSH, NJVV, ASCK | MPB, MA, MD, NJVV, OJF | 7,651 | 7,651 | 7,290 | 7,290 | 29,882 | 25,521 | 4,000 | 361 | 311,273 | 265,847 | 41,667 | 3,759 |
| Objektivi specifik II.3: Sigurimi i shërbimeve të integruara dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të të gjitha formave të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit | 2027 | 2030 | 0 | 0 | 4,700 | 4,700 | 4,700 | 4,700 | 18,800 | 7,600 | 2,800 | 8,400 | 195,833 | 79,167 | 29,167 | 87,500 |
| Masa II.3.1.Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve të specializuara për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje | 2027 | 2030 | MSHMS, SHSSH, ASHDMF, NJVV, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, QKPMR | NJVV, OJF, Partner, ASCK, ASHDM, MPB, KRAT, Policia e shtetit | 4,700 | 4,700 | 4,700 | 4,700 | 18,800 | 7,600 | 2,800 | 8,400 | 195,833 | 79,167 | 29,167 | 87,500 |
| Objektivi specifik II.4 Forcimi i drejtësisë miqësore për fëmijët dhe mbrojtja efektive e fëmijëve viktima, dëshmitarë ose në konflikt me ligjin nga riviktimizimi dhe trauma sekondare | 2027 | 2030 | 0 | 0 | 6,344 | 6,326 | 5,305 | 4,487 | 22,462 | 19,052 | 706 | 2,704 | 233,977 | 198,456 | 7,354 | 28,167 |
| Masa II.4.1 Përmirësimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët në sistemin e drejtësisë | 2027 | 2030 | MD, MSHMS, DNJF | MPB, ASHDMF, KSHNJ, Shkolla e Magjistraturës, OJF | 1,975 | 1,975 | 955 | 136 | 5,042 | 4,282 | - | 760 | 52,519 | 44,602 | - | 7,917 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa II.4.2 Rritja e kapaciteteve të profesionistëve për trajtimin e fëmijëve në sistemin e drejtësisë | 2027 | 2030 | MD, MSHMS, MPB, DPSHPSH | ASHDM, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, OJF | 1,205 | 1,187 | 1,187 | 1,187 | 4,765 | 2,115 | 706 | 1,944 | 49,640 | 22,036 | 7,354 | 20,250 |
| Masa II.4.3 Parandalimi i riviktimizimit dhe traumës sekondare gjatë procedurave ligjore | 2027 | 2030 | MD, MPB, MSHMS, DPB, Shërbimi i Provës | ASHDM, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, OJF | 3,164 | 3,164 | 3,164 | 3,164 | 12,655 | 12,655 | - | - | 131,818 | 131,818 | - | - |
| Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike | - | - | - | - | 302,498 | 300,579 | 304,514 | 308,473 | 1,216,063 | 666,673 | 273,860 | 275,530 | 12,667,324 | 6,944,512 | 2,852,708 | 2,870,104 |
| Objektivi specifik III.1.1 Forcimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit për të garantuar rritjen e fëmijëve në mjedise familjare të sigurta dhe mbështetëse | 2027 | 2030 | - | - | 50,898 | 54,553 | 58,207 | 62,166 | 225,825 | 200,985 | 15,360 | 9,480 | 2,352,339 | 2,093,589 | 160,000 | 98,750 |
| Masa III.1.1.Zhvillimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit | 2027 | 2030 | MSHMS, SHSSH, NJVV, PMF, ASHDMF | Partnerë, OJF, AKSK, Universitet | 50,898 | 54,553 | 58,207 | 62,166 | 225,825 | 200,985 | 15,360 | 9,480 | 2,352,339 | 2,093,589 | 160,000 | 98,750 |
| Objektivi specifik III.2.1 Garantimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët | 2027 | 2030 | - | - | 138,171 | 137,637 | 137,917 | 137,917 | 551,643 | 173,793 | 113,100 | 264,750 | 5,746,278 | 1,810,341 | 1,178,125 | 2,757,813 |
| Masa III.2.1 Garantimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët | 2027 | 2030 | NJVV, MSHMS, MA, MTKS | MSHMS, MA, OJF, INSTAT, Universitetet, MTKS, AKAP, ISHP, OSHKSH, | 138,171 | 137,637 | 137,917 | 137,917 | 551,643 | 173,793 | 113,100 | 264,750 | 5,746,278 | 1,810,341 | 1,178,125 | 2,757,813 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | DRAP, ZVAP, NJVV, Policia e Shtetit | | | | | | | | | | | | |
| Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në shërbime cilësore shëndetësore dhe mirëqenie psikologjike | 2027 | 2030 | - | - | 81,793 | 76,753 | 76,753 | 76,753 | 312,050 | 237,350 | 73,400 | 1,300 | 3,250,525 | 2,472,400 | 764,583 | 13,542 |
| Masa III.3.1 Forcimi i shërbimeve të shëndetit fizik dhe mendor për fëmijët dhe adoleshentët | 2027 | 2030 | MSHMS, MA, OSHKSH | NJVV, OJF, MSHMS, | 81,793 | 76,753 | 76,753 | 76,753 | 312,050 | 237,350 | 73,400 | 1,300 | 3,250,525 | 2,472,400 | 764,583 | 13,542 |
| Objektivi specifik III.4 Transformimi digjital dhe përdorimi etik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të të drejtave të fëmijëve dhe mirëqënies së tyre | 2027 | 2030 | | | 31,636 | 31,636 | 31,636 | 31,636 | 126,545 | 54,545 | 72,000 | - | 1,318,182 | 568,182 | 750,000 | - |
| Masa III.4.1 Përmirësimi i infrastrukturës digjitale në arsim për akses të barabartë të fëmijëve në teknologji | 2027 | 2030 | MA, MA, MSHMS | ASHDM, AKSK, AKEP, OJF, partnerë, KMDHP, NJVV, AKSHI, Donatorë | 31,636 | 31,636 | 31,636 | 31,636 | 126,545 | 54,545 | 72,000 | - | 1,318,182 | 568,182 | 750,000 | - |
| Masa III.4.2 Integrimi i teknologjive inovative dhe inteligjencës artificiale në arsim | 2027 | 2030 | MA | AKSHI, universitete, | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

## Tabela 2: Kosto indikative e Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, e detajuar.

| NDERHYRJET | AFATI ZBATIMIT | | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AFATI I FILLIMIT | AFATI I MBARIMIT | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET KONTRIBUESE | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| **TOTALI** | | | | | **509,841** | **509,930** | **496,244** | **475,985** |
| **Qëllimi strategjik I: Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore dhe ndër-sektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve.** | | | | | **10,373** | **21,000** | **17,569** | **10,152** |
| **Objektivi I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët.** | **2027** | **2030** | | | **10,373** | **21,000** | **17,569** | **10,152** |
| **Masa prioritare I.1.1: Qeverisje ndër-sektoriale funksionale dhe llogaridhënie për zbatimin e politikave për fëmijët.** | **2027** | **2030** | **(MSHMS, ASHMDF, Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme, MB, MM, Fakulteti i Gazetarisë)** | **ASHMDF, Ministritë e linjës, institucionet e tjera pjesë e KKDMF-së, Partnerë, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, Universitetet, institucionet kërkimore, INSTAT, Ministri për Pushtetin Vendor/ Agjencia e Mbështetjes së vetëqeverisjes Vendore, Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), MAS, OJF** | **5,830** | **15,232** | **11,942** | **5,950** |
| 1.1.1.a: Vlerësimi i zbatimit të ligjit për të drejtat e fëmijëve. | 2028 | 2029 | MSHMS, ASHMDF | Partnerë | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.1.a/1: Hartimi i propozimeve për rishikimin e ligjit “Për të drejtat e fëmijëve” për të forcuar arkitekturën institucionale për zbatimin e ligjit të të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. | 2028 | 2029 | MSHMS, ASHMDF | Partnerë | - | *341* | *1,151* | - |
| I.1.1.b: Rivitalizimi dhe garantimi i qendrueshmërisë së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF), si mekanizëm qendror për koordinimin, monitorimin dhe raportimin ndërsektorial të zbatimit të politikave për fëmijët, përmes zhvillimit të rregullt të veprimtarisë së tij dhe forcimit të rolit institucional. Përditësimi i përfaqësimit të organizatave të shoqërisë civile në KKDMF dhe zgjerimi i pjesëmarrjes së fëmijëve dhe adoleshentëve, me synim rritjen e përfaqësimit, përfshirjes dhe qëndrueshmërisë së mekanizmave pjesëmarrës në proceset vendimmarrëse. | 2027 | 2030 | MSHMS | ASHMDF, ministritë e linjës, institucionet e tjera pjesë e KKDMF-së | - | - | - | - |
| I.1.1.c: Integrimi i çështjeve të fëmijëve në agjendën e punës së Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara, në koordinim me Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve (KKDMF). | 2027 | 2030 | MSHMS | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës | - | - | - | - |
| 1.1.1.ç: Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të ASHMDF për ushtrimin e rolit drejtues, koordinues dhe monitorues në nivel kombëtar dhe vendor për zbatimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. | 2027 | 2030 | MSHMS, ASHMDF | | *3,600* | *3,600* | *3,600* | *3,600* |
| I.1.1.d: Hartimi dhe raportimi vjetor i zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve në KKMDF dhe Parlament - Grupi parlamentar “Miqtë e fëmijëve”. | 2027 | 2030 | ASHMDF | MSHMS | *450* | *450* | *450* | *450* |
| I.1.1.dh: Forcimi i raportimit vjetor të institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut mbi trajtimin e ankesave dhe monitorimin e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, përfshirë integrimin e të dhënave për të drejtat e fëmijëve në raportet e tyre vjetore dhe raportimin në KKDMF dhe Grupin Parlamentar “Miqtë e Fëmijëve”. | 2027 | 2030 | Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | MSHMS | *450* | *450* | *450* | *450* |
| 1.1.1.e: Zhvillimi i një mekanizmi monitorues (dashboard) për ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve (CRC, CEDAW, UPR). | 2027 | 2029 | MSHMS, Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme | ASHMDF<br>Ministri të linjës | *341* | *5,091* | *2,841* | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1.ë: Zhvillimi dhe institucionalizimi i metodologjisë për buxhetimin e ndjeshëm ndaj fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.<br>Trajnimi i specialistëve mbi metodologjinë. | 2028 | 2030 | MSHMS, MF | Partnerë | - | *3,350* | *2,000* | - |
| I.1.1.f: Ngritja dhe funksionimi i një grupi pune ndër-sektoriale për të hartuar dhe koordinuar iniciativën e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët, në koordinim me KKDMF. | 2028 | 2030 | ASHMDF | Ministri për Pushtetin Vendor/ Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, MSHMS | - | *205* | *205* | *205* |
| I.1.1.g: Integrimi i të drejtave të fëmijëve në planifikimin për emergjenca civile dhe ndryshimet klimatike, si dhe ofrimi i shërbimeve miqësore për fëmijët gjatë krizave. | 2027 | 2030 | MPB, AKMC | ASHDMF, MSHMS, ISHP | *300* | *300* | *300* | *300* |
| I.1.1.gj: Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet ASHDMF-së, Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHTI), institucioneve akademike dhe aktorëve të tjerë relevantë, për zhvillimin dhe promovimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. | 2027 | 2030 | ASHMDF | Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, Universitetet, Institucionet Kërkimore, INSTAT | *102* | - | - | - |
| I.1.1.h Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet ASHDMF-së dhe organizatave të shoqërisë civile për forcimin e rolit të tyre në ndërgjegjësimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve | 2027 | 2030 | ASHMDF | Agjensia për Mbështetjen e Shoqërive Civile, MSHMS | *50* | *50* | *50* | *50* |
| I.1.1. i: Zhvillimi dhe integrimi i moduleve mbi etikën profesionale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në programet e studimit të gazetarisë dhe komunikimit, me fokus në raportimin etik, konfidencialitetin dhe trajtimin e rasteve që përfshijnë të mitur. | 2027 | 2030 | ASHDMF, Fakulteti i Gazetarisë | Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) | *102* | *961* | *461* | *461* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1.j: Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve, profesionistëve të komunikimit publik dhe pikave fokale për të drejtat e fëmijëve në institucionet publike dhe jo-publike mbi të drejtat e fëmijëve, komunikimin etik, mbrojtjen e privatësisë dhe raportimin e përgjegjshëm të çështjeve që lidhen me fëmijët. | 2027 | 2030 | ASHDMF | AMA, MAS, institucionet publike, OJF | *434* | *434* | *434* | *434* |
| | | | | | - | - | - | - |
| | | | | | - | - | - | - |
| Masa prioritare I.1.2: Forcimi i sistemit kombëtar të integruar, të digjitalizuar dhe të standardizuar të të dhënave, monitorimit dhe vlerësimit për të drejtat e fëmijëve | 0 | 0 | **INSTAT, MSHMS, SHSSH** | **Minsitritë e Linjës, NJVV** | 1,002 | 2,227 | 2,427 | 1,002 |
| I.1.2.a: Përfshirja e treguesve me fokus fëmijët dhe adoleshentët në MoU e INSTAT dhe instituiconeve shtetërore në zbatim të programit të ri të Statistikave zyrtare. | 2027 | 0 | INSTAT | Ministritë e linjës | - | - | - | - |
| I.1.2.b: Planifikimi i punës për hartimin e anketës MICS 2030. | 2029 | 2030 | INSTAT | Ministritë e linjës | - | - | - | - |
| I.1.2. c: Përgatitja dhe publikimi çdo tre vite i botimit analitik statistikor për fëmijët, adoleshentëve dhe të rinjve. | 2027 | 2030 | INSTAT | MSHMS, ministritë e linjës, Partnerë | 450 | 450 | 450 | 450 |
| I.1.2.ç: Përditësimi çdo vit i platformës digjitale me të dhënat zyrtare për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë. Komunikimi i rregullt me partnerët mbi të dhënat. | 2027 | 2030 | INSTAT | MSHMS, ministritë e linjës, Partnerë | 450 | 450 | 450 | 450 |
| I.1.2.d: Krijimi i grupit të punës dhe kryerja e vlerësimit mbi ekosistemin e të dhënave/statistikave me fokus fëmijët, aoleshetnët dhe të rinjtë në Shqipëri. | 2028 | 2028 | MSHMS | INSTAT | - | - | - | - |
| I.1.2.e: Përgatitja e një analize gjithëpërfshirëse dhe të përditësuar mbi situatën e fëmijëve. | 2028 | 2029 | MSHMS | INSTAT ASHMDF, ministri të linjës, Partnerë | - | 1,225 | 1,425 | - |
| I.1.2.ë: Përditësimi dhe promovimi i platformës kombëtare të statistikave për fëmijët (statistikafemijet.gov.al) me të dhëna të standardizuara nga institucionet përgjegjëse. | 2027 | 2030 | ASHMDF | INSTAT, ministri të linjës, NJVV | 102 | 102 | 102 | 102 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | - | - | - | - |
| **Masa prioritare I.1.3: Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve** | | | MA, MSHMS, Bashkitë | Partnerë | 3,541 | 3,541 | 3,200 | 3,200 |
| I.1.3.a: Ngritja e strukturave/mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror (pranë KKMDF, parlament, institucionet e pavarura, etj.) dhe vendor. | 2027 | 2028 | MA, MSHMS | Partnerë | 400 | 400 | 400 | 400 |
| I.1.3.b: Hartimi dhe shpërndarja e materialeve informuese në gjuhë miqësore për fëmijët mbi KDF, AKDF 2027-2030 dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve, duke siguruar aksesueshmëri për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e komuniteteve rome dhe egjiptiane. | 2027 | | ASHDMF | Partnerë | 800 | 800 | 800 | 800 |
| I.1.3.c: Vlerësimi i zbatimit të Udhërit nr. 367, datë 09.06.2020 për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe rishikimi i saj për forcimin e mekanizmave funksional dhe të qëndrueshëm të pjesëmarrjes në nivel qendror dhe vendor. | 2027 | 2028 | MSHMS, ASHDMF | Partnerë | 341 | 341 | - | - |
| I.1.3.d: Fuqizimi i qeverive dhe parlamenteve të nxënësve, si dhe i strukturave të tjera të pjesëmarrjes së fëmijëve, për të promovuar përfshirjen aktive të tyre në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbrojtës në shkollë, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për parandalimin e dhunës, bullizmit dhe rritjen e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare. | 2027 | 2030 | MA | AKAP, DRAP, ZVAP | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| **Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve.** | | | | | **196,970** | **188,351** | **174,161** | **157,360** |
| **Objektivi specifik II.1: Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.** | **2027** | **2030** | | | **163,538** | **165,525** | **153,347** | **138,529** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa II.1.1. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe ndryshimi i normave sociale që tolerojnë dhunën ndaj fëmijëve.** | **2027** | **2030** | **ASHDMF, MSHMS, AMA** | **NJVV-të, OJF-të, MKR, AMA, KRAT, IPSH, OSHKSH, AP** | **7,284** | **8,875** | **2,255** | **9,255** |
| II.1.1.a: ASHDMF, në bashkëpunim me Partnerëë, mbështet realizimin e një studimi të pavarur kombëtar me dy valë (2027-2029) për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të popullsisë ndaj dhunës ndaj fëmijëve, të realizuar nga institucione të specializuara sipas metodave shkencore të kërkimit. | 2027 | 2030 | ASHDMF | Partnerë | *2,500* | *4,500* | - | *7,000* |
| II.1.1.b: Hartimi i një plani kombëtar komunikimi për adresimin e normave negative sociale që justifikojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve. | 2027 | 2028 | ASHDMF, MSHMS | NJVV, Partnerëë | *2,120* | *2,120* | - | - |
| II.1.1.c: Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve informuese (video, guida, fletëpalosje, materiale digjitale) mbi të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve:<br>- të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve;<br>- pasojat e dhunës;<br>- mënyrat e raportimit dhe mbrojtjes. | 2027 | 2030 | ASHDMF, MSHMS | NJVV, Partnerëë | *630* | *630* | *630* | *630* |
| II.1.1.ç: Organizimi dhe zbatimi i fushatave kombëtare dhe lokale ndërgjegjësuese për promovimin e mbrojtjes, mirëqenies dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve dhe adoleshentëve, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare sektoriale, duke adresuar në mënyrë të integruar. | 2027 | 2030 | MSHMS | MKR, NJVV,<br>ASHMDF, IPSH,<br>OSHKSH, AP<br>KRAT<br>AMA, OJF<br>ON, TV<br>Kombëtare dhe Lokale<br>Qendra Komunitare<br>Multi-funksionale | *890* | *890* | *890* | *890* |
| II.1.1.d: Angazhimi i mediave, liderëve komunitarë dhe figurave publike në promovimin e mesazheve kundër dhunës ndaj fëmijëve. | 2027 | 2030 | ASHDMF, AMA | MKR, NJVV,<br>ASHMDF, IPSH,<br>OSHKSH, AP<br>KRAT<br>AMA, OJF<br>ON, TV<br>Kombëtare dhe Lokale<br>Qendra Komunitare<br>Multi-funksionale | *735* | *735* | *735* | *735* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.1.dh: Rivitalizimi dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ASHDMF-së dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për promovimin e raportimit etik dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në media, përmes zhvillimit të takimeve të rregullta, udhëzimeve dhe mekanizmave monitorues. | 2027 | 2027 | ASHDMF, AMA | | *409* | - | - | - |
| **Masa II.1.2. Promovimi i prindërimit pozitiv dhe mbështetja e familjeve për rritjen e fëmijëve pa dhunë.** | | | **ASHDMF, MSHMS, NJVQV-të** | **NJVV-të, OJF-të, MKR, AMA, KRAT, AP** | **4,862** | **5,299** | **4,041** | **4,041** |
| II.1.2.a: Hartimi dhe përditësimi periodik i Udhëzuesit Kombëtar për Prindërimin Pozitiv dhe materialeve të aksesueshme për prindër dhe profesionistë të shërbimeve sociale, arsimit dhe shëndetësisë | 2027 | 2028 | *MSHMS, MA* | *ASHDMF, SHSSH, ISHP, QKTRF, NJQQV, Partnerë, ISHP, Universitete, OJF* | *821* | *1,258* | - | - |
| II.1.2.b: Integrimi i komponentëve të prindërimit pozitiv në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor (p.sh. gjatë vizitave rutinë për nënat dhe fëmijët) dhe në aktivitetet edukative në shkolla, si mekanizma të hershëm identifikimi dhe mbështetjeje për familjet. | 2027 | 2030 | *MSHMS, MA* | *ASHDMF, DRSH, ZVA, NJVV* | - | - | - | - |
| II.1.2.c: Zbatimi i programeve të strukturuara të prindërimit pozitiv përmes qendrave komunitare, shkollave dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor si pika hyrëse për familjet. | 2027 | 2030 | NJVV, ASHDMF | Partnerë | *1,185* | *1,185* | *1,185* | *1,185* |
| II.1.2.ç: Ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale për prindërit përmes shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, mbi prindërimin pozitiv, menaxhimin e konflikteve familjare, zhvillimin emocional të fëmijëve dhe ndarjen e përgjegjësive prindërore, si dhe mbi përballimin e situatave të vështira, varësive, sjelljeve të rrezikshme dhe faktorëve të tjerë që cenojnë mirëqenien e fëmijëve. | 2027 | 2030 | *NJVV, ASHDMF* | *Partnerëë, OJF* | *980* | *980* | *980* | *980* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.2.dh: Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të strukturuara të informimit, këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me nevoja të posaçme, me fokus fuqizimin e familjes dhe mbështetjen e zhvillimit të fëmijës | 2027 | 2030 | MSHMS, ASHDMF | *MA, NJVV, OJF, SHSSH* | *696* | *696* | *696* | *696* |
| II.1.2.e: Bashkëpunimi me median për promovimin e modeleve pozitive të prindërimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi praktikat e rritjes pa dhunë | 2027 | 2030 | ASHDMF, NJVV, AMA | *Partnerë* | *1,180* | *1,180* | *1,180* | *1,180* |
| | | | | | - | - | - | - |
| **Masa II.1.3: Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve në mjedisin shkollor dhe promovimi i një kulture pozitive në shkolla.** | **2027** | **2030** | **ASHDMF, MSHMS, MA** | **NJVV-të, OJF-të, ZVA, Partnerë** | **125,473** | **125,773** | **121,473** | **121,473** |
| II.1.3.a: Zhvillimi dhe zbatimi i programeve edukative në shkolla mbi:<br>- parandalimin e bullizmit;<br>- dhunën mes bashkëmoshatarëve;<br>- respektin dhe tolerancën;<br>- barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin; duke përfshirë informacion mbi mekanizmat e raportimit dhe shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve.<br>- për menaxhimin e sjelljes, përfshirjen sociale dhe parandalimin e përjashtimit dhe dhunës në shkolla. | 2027 | 2030 | ZVA, ASHDMF, NJVV | MA, MSHMS, Partnerë | *56,600* | *56,600* | *56,600* | *56,600* |
| II.1.3.b: Organizimi i workshop-eve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese për nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi identifikimin e hershëm të dhunës, mekanizmat e raportimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse në mekanizmin e referimit ndërinstitucional. | 2027 | 2030 | ZVA, ASHDMF, NJVV (NJMF) | MA, MSHMS, Partnerë | *56,600* | *56,600* | *56,600* | *56,600* |
| II.1.3.c: Forcimi i sigurisë në shkolla përmes rritjes së numrit të oficerëve të sigurisë dhe përcaktimit të rolit të tyre në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e referimit. PVK për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore - Masa 1.3. | 2027 | 2027 | MA, MB, ASHDMF | MSHMS | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.3.ç: Krijimi i iniciativave të udhëhequra nga adoleshentët për promovimin e një kulture shkollore pa dhunë, përmes ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve, aktiviteteve sensibilizuese dhe nismave kundër bullizmit, në bashkëpunim me strukturat e shkollës dhe shërbimet vendore të mbrojtjes së fëmijëve. | 2027 | 2030 | ZVA, ASHDMF, NJVV | MA, MSHMS, Parnerë | *8,273* | *8,273* | *8,273* | *8,273* |
| II.1.3.d: Trajnimi i mësuesve, psikologëve, oficerëve të sigurisë dhe punonjësve socialë për identifikimin e hershëm të rasteve, referimin sipas procedurave standard, menaxhimin fillestar të rasteve në koordinim me NJMF dhe strukturat vendore. | 2027 | 2028 | MA, ASCAP | MSHMS, NJVV, ASHDMF, MB | *3,150* | *3,150* | - | - |
| II.1.3.dh: Investime në infrastrukturën arsimore: - ndërtimi dhe pajisja e hapësirave bashkëkohore brenda dhe jashtë shkollës për të inkurajuar aktivitete sportive; - ndërtimi dhe rikonstruksioni i institucioneve arsimore; - hapësira dhe mekanizma mbështetës për mirëqenien emocionale dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme, përfshirë klasa mbështetëse dhe ambiente për ndërhyrje individuale dhe rregullim emocional. PVK për fuqizimin e mekanizmave të parandlimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore –- Masa 1.10. | 2027 | 2030 | MA | NJVV | - | - | - | - |
| II.1.3.e: Ritje e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social për mirëqënien e nxënësve në shkolla, duke siguruar lidhje funksionale me NJMF dhe shërbimet sociale për ndjekjen e rasteve.<br><br>+350 punonjës të shërbimit psiko-social. PVK për fuqizimin e mekanizmave të parandlimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore – Masa 2.1. | 2027 | 2027 | MA | MA | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.3.ë: Zhvillimi i kornizës së politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore, në përputhje me sistemin kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e referimit. | 2027 | 2028 | MA | Partnerë | *850* | *1,150* | - | - |
| II.1.3.f: Hartimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve nga vetë institucionet arsimore me pjesëmarrjen e fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si iniciativë e çdo shkolle (udhëhequr nga Senatet e fëmijëve dhe Këshilli i Prindërve). | 2027 | 2028 | MSHMS, ASHDMF | MA, Partnerë | - | - | - | - |
| II.1.3.g: Forcimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe mbështetjes psiko-sociale në kopshte dhe shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes rritjes së mbulimit me mësues ndihmës, staf psiko-social dhe mekanizma mbështetës për menaxhimin e sjelljes dhe përfshirjen sociale.<br>REF: PVPAK Fusha Arsimi , Masa Prioritare 2.3 - Mbështetje profesionale, kurrikulare për nxënie gjithëpërfshirëse për nxënësit me aftësi të kufizuara. Aktiviteti 2.3.1. | 2027 | 2030 | MA | MSHMS, ASHDMF, NJVV | - | - | - | - |
| **Masa II.1.4: Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes edukimit mbi sigurinë digjitale, përdorimin e sigurt të internetit, parandalimin dhe raportimin e dhunës online, si dhe mbrojtjen e privatësisë dhe integritetit të tyre në mjedisin digjital** | **2027** | **2030** | **MA, ASHDMF, NJVV, AKSK** | **MSHMS, NJVV, Partnerë** | **25,919** | **25,578** | **25,578** | **3,760** |
| II.1.4.a: Zgjerimi i aksesit të fëmijëve në internet dhe teknologji digjitale, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, përmes përmirësimit të infrastrukturës digjitale, forcimit të aftësive dhe kompetencave digjitale të fëmijëve, mësuesve dhe familjeve. | 2027 | 2028 | MA | Partnerë | - | - | - | - |
| II.1.4.b: Integrimi i edukimit për sigurinë digjitale dhe identifikimin e rreziqeve në mjedisin online në programet e edukimit në shkolla. | 2027 | 2029 | MA, ASCAP | ZVA, Shkollat, Partnerë | *21,818* | *21,818* | *21,818* | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.4.c: Zhvillimi dhe zbatimi i ndërhyrjeve të integruara për sigurinë e fëmijëve në internet, për fëmijët, prindërit dhe komunitetin shkollor, përmes materialeve informuese, programeve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e sigurt të internetit dhe parandalimin e rreziqeve digjitale. | 2027 | 2030 | NJVV, ZVA, ASHDMF, AKSK | OJF, Partnerë | *3,610* | *3,610* | *3,610* | *3,610* |
| II.1.4.ç: Zhvillimi i programeve të trajnimit për prindërit mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe përdorimin e sigurt të teknologjisë për fëmijët dhe procedurat bazë për kërkimin e ndihmës dhe raportimin e rasteve. | 2027 | 2030 | NJVV, ASHDMF, AKSK | Partnerë | *150* | *150* | *150* | *150* |
| | | | | | - | - | - | - |
| II.1.4.d: Hartimi dhe zbatimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe ASHDMF-së për forcimin e mekanizmave të identifikimit, referimit, koordinimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve viktima ose në rrezik të dhunës, bullizmit kibernetik, grooming, shfrytëzimit seksual online dhe formave të tjera të rrezikut në mjedisin digjital. | 2027 | | Policia e Shtetit, ASHDMF | MSHMS, MA, AKSK, DRAP/ZVAP, NJVV, OJF, Partnerëë | *341* | - | - | - |
| II.1.4.dh: Përditësimi i protokolleve/procedurave për sigurinë në shkolla duke përfshirë:<br>- sigurinë kibernetike dhe sjelljen etike në mjediset digjitale;<br>- procedurat për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës digjitale ndaj fëmijëve;<br>- lidhjen me mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve (NjMF, Policia e Shtetit, strukturat përkatëse).<br>PVK për fuqizimin e mekanizmave të parandlimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore – Masa 1.8. | 2027 | 2028 | MA, ASHDMF, AKSK, PSH | NJVV, Partnerë | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.4.e: Krijimi dhe funksionalizimi i një rrjeti kombëtar të mbështetjes digjitale për sigurinë online dhe mirëqenien e nxënësve, që përfshin:<br>- platforma dhe linja këshillimi për fëmijët dhe prindërit<br>- mekanizma të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për raportimin e rasteve<br>- orientimin e rasteve drejt strukturave të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit (NjMF, Policia, Prokuroria sipas rastit).<br>PVK për fuqizimin e mekanizmave të parandlimit të dhunës dhe bullizmit në institucionet arsimore – Masa 2.5 | 2027 | 2028 | MA, AKSK | Partnerë | - | - | - | - |
| **Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike.** | | | | | **302,498** | **300,579** | **304,514** | **308,473** |
| **Objektivi specifik III.1.1: Forcimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit për të garantuar rritjen e fëmijëve në mjedise familjare të sigurta dhe mbështetëse.** | **2027** | **2030** | | | **50,898** | **54,553** | **58,207** | **62,166** |
| **Masa III.1.1: Zhvillimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit.** | **2027** | **2030** | **MSHMS, SHSSH, NJVV, PMF, ASHDMF,** | **Partnerë, OJF, AKSK, Universitet** | **50,898** | **54,553** | **58,207** | **62,166** |
| III.1.1.a: Zgjerimi i shërbimit të familjeve kujdestare dhe rritja e numrit të familjeve kujdestare vullnetare dhe profesionale të trajnuara, vlerësuara dhe të certifikuara, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për kujdesin alternativ të fëmijëve. | 2027 | 2030 | *MSHMS, SHSSH, NJVV* | *Partnerë, OJF* | *7,320* | *7,320* | *7,320* | *7,320* |
| III.1.1.b: Zhvillimi i programeve për reintegrimin e fëmijëve në familjen biologjike, kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. | 2027 | 2030 | *NJVV, NJMF* | *OJF* | *3,959* | *7,614* | *11,268* | *15,227* |
| III.1.1.c: Zhvillimi i programeve për mbështetjen e tranzicionit drejt pavarësisë për të rinjtë që dalin nga kujdesi alternativ, përfshirë mbështetjen për strehim, arsim dhe punësim. | 2027 | 2030 | *NJVV, PMF, SHSSH* | *OJF* | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III.1.1.ç: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve parandaluese dhe mbështetëse për familjet biologjike, me qëllim parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja dhe ruajtjen e mjedisit familjar kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. | 2027 | 2030 | *NJVVN* | *Partnerë* | *39,373* | *39,373* | *39,373* | *39,373* |
| III.1.1.d: Zhvillimi i shërbimeve të specializuara të kujdesit alternativ për fëmijët me nevoja komplekse, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët viktima të dhunës, trafikimit dhe shfrytëzimit. | 2027 | 2030 | *NJVV* | *Partnerë* | - | - | - | - |
| III.1.1.dh: Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale për zbatimin e standardeve të kujdesit alternativ dhe mbrojtjes së fëmijëve. | 2027 | 2030 | *MSHMS, ASHDMF, SHSSH* | *AKSK, Universitet, OJF* | *246* | *246* | *246* | *246* |
| | | | | | - | - | - | - |
| **Objektivi specifik III.2.1: Garantimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët.** | **2027** | **2030** | | | **138,171** | **137,637** | **137,917** | **137,917** |
| **Masa III.2.1: Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së arsimit për të gjithë fëmijët.** | **2027** | **2030** | **NJVV, MSHMS, MA,** | **MSHMS, MA, OJF, INSTAT, Universitetet, Ministria Kulturës, Turizmit dhe Sportit, AKAP, ISHP, OSHKSH, DRAP, ZVAP, NJVV, Policia e Shtetit** | 138,171 | 137,637 | 137,917 | 137,917 |
| III.2.1.a: Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, veçanërisht në zonat rurale dhe komunitetet vulnerabël, përmes përmirësimit të cilësisë dhe mbështetjes për familjet me të ardhura të ulëta. | 2027 | 2030 | NJVV | MSHMS, MA, OJF | *12,200* | *12,200* | *12,200* | *12,200* |
| III.2.1.b: Forcimi i mbledhjes, raportimit dhe shkëmbimit të të dhënave administrative për çerdhet ndërmjet institucioneve përgjegjëse, në funksion të prodhimit gradual të statistikave zyrtare dhe planifikimit të politikave për kujdesin në fëmijërinë e hershme | 2027 | 2030 | MSHMS, NJVV, MA | INSTAT | *6,450* | *6,450* | *6,450* | *6,450* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III.2.1.c: Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave të hershëm për identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve në rrezik braktisjeje shkollore, përmes bashkëpunimit ndërmjet shkollave, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimeve sociale, si dhe zgjerimit të programeve dhe shërbimeve pas shkolle. | 2027 | 2030 | MA | NJVV, MSHMS, OJF | *600* | *600* | *600* | *600* |
| III.2.1.ç: Zgjerimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar aksesin fizik në shkolla, pajisjet ndihmëse dhe mbështetjen profesionale. | 2027 | 2030 | MA | NJVV, MSHMS, OJF | *73,250* | *72,500* | *72,500* | *72,500* |
| III.2.1.d: Rritja e numrit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta arsimore. PKVPAK 2026-20230 Masa Prioritare 2.3 Mbështetje profesionale, kurrikulare për nxënie gjithëpërfshirëse për nxënësit me aftësi të kufizuara. | 2027 | 2030 | MA | NJVV, Universitetet | - | - | - | - |
| III.2.1.e: Integrimi i aftësive digjitale dhe socio-emocionale në procesin arsimor, përmes zhvillimit të kurrikulës dhe trajnimit të mësuesve. | 2027 | 2030 | MA | ASCAP | *1,680* | *1,960* | *2,240* | *2,240* |
| III.2.1.e: Nxitja e aktiviteteve sportive, kulturore dhe rekreative në mjediset formale dhe joformale arsimore, si mekanizma për promovimin e mirëqenies, parandalimin e dhunës, bullizmit dhe përjashtimit social, si dhe forcimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet kulturore e sportive, shoqërinë civile, median dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijëve | 2027 | 2030 | MA, NJVV | Ministria Kulturës, Turizmit dhe Sportit, Partnerë | *15,000* | *15,000* | *15,000* | *15,000* |
| III.2.1.ë: Zgjerimi i modelit "Shkolla Qendër Komunitare" në institucionet arsimore parauniversitare, veçanërisht në zonat me nivel të lartë vulnerabiliteti social. | 2027 | 2030 | MA | ASCAP, AKAP, NJVV | - | - | - | - |
| III.2.1.f: Promovimi i artneriteteve midis shkollave, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve lokale për zhvillimin e aktiviteteve komunitare dhe edukative. | 2027 | 2030 | MA, MTKS | NJVV, OJF | *8,545* | *8,545* | *8,545* | *8,545* |
| III.2.1.g: Hartimi dhe zbatimi i planeve vendore të përmirësimit nga ZVAP dhe bashkitë, me fokus promovimin e shëndetit dhe ndërgjegjësimin për parandalimin e obezitetit, duhanpirjes, alkoolit dhe përdorimit të substancave narkotike tek fëmijët dhe të rinjtë. | 2027 | 2030 | MA, MTKS | MSHMS, NJVV, DRAP/ZVAP, ISHP, OJF | *10,545* | *10,545* | *10,545* | *10,545* |
| III.2.1.gj: Forcimi i rolit të psikologëve, punonjësve socialë, mjekëve dhe infermierëve shkollorë në institucionet arsimore, për promovimin e edukimit shëndetësor, identifikimin e hershëm të problematikave | 2028 | 2030 | MSHMS, MA | ISHP, OSHKSH, DRAP/ZVAP, NJVV | - | *836* | *836* | *836* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| shëndetësore dhe psikosociale, si dhe ofrimin e mbështetjes dhe referimit për nxënësit në nevojë. | | | | | | | | |
| III.2.1.h: Zhvillimi dhe funksionalizimi i një sistemi të standardizuar për mbledhjen, raportimin, analizimin dhe monitorimin e të dhënave mbi rastet e dhunës, bullizmit dhe incidenteve që cenojnë sigurinë e fëmijëve në institucionet arsimore. | 2027 | 2028 | MA | ASHDMF, MSHMS, AKSHI, DRAP/ZVAP, NJVV, Policia e Shtetit | *900* | - | - | - |
| II.2.1.i: Ngritja dhe funksionalizimi i një strukture/Instituti për neurodivergjencën, në bashkëpunim ndërmjet MA dhe MSHMS, për zhvillimin e politikave, standardeve dhe shërbimeve mbështetëse për fëmijët me nevoja specifike zhvillimore. | 2027 | 2030 | MSHMS, MTKS | MA, ASHMDF, ISHP, Universitete, OJF | *9,000* | *9,000* | *9,000* | *9,000* |
| **Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në shërbime cilësore shëndetësore dhe mirëqenie psikologjike.** | **2027** | **2030** | | | **81,793** | **76,753** | **76,753** | **76,753** |
| **Masa III.3.1: Forcimi i shërbimeve të shëndetit fizik dhe mendor për fëmijët dhe adoleshentët.** | **2027** | **2030** | **MSHMS, MA** | **NJVV, OJF, MSHMS** | 81,793 | 76,753 | 76,753 | 76,753 |
| III.3.1.a: Zgjerimi dhe forcimi i programeve të vizitave në familje (home visiting) për foshnjat, fëmijët e vegjël në situatë vulnerabiliteti, me qëllim identifikimin e hershëm të nevojave shëndetësore, zhvillimore dhe sociale, promovimin e kujdesit prindëror dhe referimin në shërbimet përkatëse. | 2027 | 2030 | MSHMS | NJVV, OJF | *22,085* | *22,085* | *22,085* | *22,085* |
| III.3.1.b: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët në komunitet. Strategjia Kombëtare për Shëndetin Mendor 2030. | 2027 | | MSHMS | NJVV, OJF | *5,040* | - | - | - |
| III.3.1.c: Shtrirja më e gjerë e shërbimeve psikosociale në shkolla, përmes rritjes së numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë në sistemin arsimor. PKVPAK 2026-2030; Fusha e Arsimit Masa Prioritare 2.3 Mbështetje profesionale, kurrikulare për nxënie gjithëpërfshirëse për nxënësit me aftësi të kufizuara. | 2027 | 2030 | MA | MSHMS, NJVV | - | - | - | - |
| III.3.1.ç: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbime shëndetësore dhe rehabilituese, përfshirë terapitë zhvillimore dhe shërbimet mbështetëse. | 2027 | 2030 | MSHMS | NJVV, OJF | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III.3.1.d: Zhvillimi i programeve për edukimin shëndetësor të fëmijëve dhe të rinjve, duke përfshirë ushqyerjen e shëndetshme, aktivitetin fizik dhe parandalimin e sjelljeve të rrezikshme | 2027 | 2030 | MSHMS | MA, ISHP, OJF | *12,000* | *12,000* | *12,000* | *12,000* |
| III.3.1.dh: Zgjerimi i programeve të vaksinimit dhe monitorimit të shëndetit të fëmijëve. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 1.Qëllimi i Politikës (Kodi, Emërtimi) Investimi në shëndetin e popullatës gjatë gjithë ciklit të jetës 1.3 Objektivi specifik: Fuqizimi dhe zgjerimi i programeve të reja të vaksinimit-imunizimit dhe qëndrueshmëria e mbulesës vaksinale. | 2027 | 2030 | MSHM | MA, OJF | *6,350* | *6,350* | *6,350* | *6,350* |
| III.3.1. e: Zhvillimi dhe zbatimi i programeve depistuese në shkolla për identifikimin e hershëm të problematikave të shikimit tek fëmijët (çdo vit). | 2027 | 2030 | MSHMS | Institucionet shëndetësore, Organizata ndërkombëtare | - | - | - | - |
| III.3.1.ë: Zhvillimi dhe zbatimi i programeve depistuese për identifikimin e hershëm të problematikave posturale dhe skoliozës tek fëmijët në institucionet arsimore (çdo vit). | 2027 | 2030 | MSHMS | MA, ISHP, OSHKSH, DRAP/ZVAP, NJVV | *13,137* | *13,137* | *13,137* | *13,137* |
| III.3.1.f: Forcimi i shërbimeve parandaluese dhe stomatologjike për fëmijët në shkolla dhe komunitet, me fokus edukimin oral dhe identifikimin e hershëm të problematikave dentare (çdo vit). | 2027 | 2030 | MSHMS | MA, ISHP, OSHKSH, DRAP/ZVAP, NJVV | *8,000* | *8,000* | *8,000* | *8,000* |
| III.3.1.g: Forcimi i shërbimeve parandaluese dhe stomatologjike për fëmijët në shkolla dhe komunitet, me fokus edukimin oral dhe identifikimin e hershëm të problematikave dentare (çdo vit). | 2027 | 2030 | MSHMS | MA, ISHP, OSHKSH, DRAP/ZVAP, NJVV | *15,180* | *15,180* | *15,180* | *15,180* |
| III.3.1.gj: Promovimi i aktivitetit fizik dhe ushqyerjes së shëndetshme për fëmijët. | 2027 | 2030 | MSHMS | MA, ISHP, OSHKSH, NJVV, organizata sportive dhe OJF | - | - | - | - |
| | | | | | - | - | - | - |
| **Objektivi specifik III.4: Transformimi digjital dhe përdorimi etik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të të drejtave të fëmijëve dhe mirëqënies së tyre.** | **2027** | **2030** | | | **31,636** | **31,636** | **31,636** | **31,636** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa III.4.1: Përmirësimi i infrastrukturës digjitale në arsim për akses të barabartë të fëmijëve në teknologji.** | **2027** | **2030** | **MA, MSHMS** | **ASHDMF, AKSK, AKEP , OJF, Partnerë, KMDHP, NJVV, AKSHI, Donatorë** | 31,636 | 31,636 | 31,636 | 31,636 |
| III.4.1.a Promovimi i sigurisë së fëmijëve në internet dhe përdorimit etik e të përgjegjshëm të teknologjive digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale, përmes programeve ndërgjegjësuese dhe edukative për prindërit, mësuesit dhe fëmijët, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave, privatësisë dhe mirëqenies së tyre në mjedisin digjital. | 2027 | 2030 | MA, MSHMS | ASHDMF, AKSK, AKEP , OJF/Partnerë | *15,818* | *15,818* | *15,818* | *15,818* |
| III.4.1.b Zhvillim i aktiviteteve ndërgjegjësuese për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve në mjedisin digjital, në zbatimi të ligjit nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". | 2027 | 2030 | MA | Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | *15,818* | *15,818* | *15,818* | *15,818* |
| III.4.1.c Zgjerimi i Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) në shkollat e arsimit parauniversitar. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 1. | 2027 | 2028 | MA | AKSHI, Bashkitë | - | - | - | - |
| III.4.1.ç Pajisja e mësuesve me pajisje digjitale për zhvillimin e procesit mësimor. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 2. | 2027 | 2030 | MA | MFE, donatorë | - | - | - | - |
| III.4.1.d Sigurimi i internetit broadband dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha institucionet arsimore. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 3. | 2027 | 2030 | MA | AKSHI | - | - | - | - |
| III.4.1.dh Furnizimi i klasave me tabela interaktive (smartboards) për përmirësimin e mësimit digjital. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 7. | 2027 | 2030 | MA | NJVV, donatorë | - | - | - | - |
| | | | | | - | - | - | - |
| **Masa III.4.2: Integrimi i teknologjive inovative dhe inteligjencës artificiale në arsim.** | **2027** | **2030** | **MA** | **AKSHI, Universitete,** | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *III.4.2.a: Zgjerimi i platformave të mbështetura nga Inteligjenca Artificiale për mësim të personalizuar. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 8*. | 2027 | 2030 | MA | AKSHI, Universitete | - | - | - | - |
| III.4.2.b: Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve për përdorimin e inteligjencës artificiale gjeneruese në arsim. *Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 14.* | 2027 | 2030 | MA | AKSHI, universitete | - | - | - | - |
| III.4.3.c: Integrimi i edukimit mbi inteligjencën artificiale në kurrikulën e TIK për nxënësit. Plani i Veprimit për Arsimin Digital 2025-2030 – Masa 16. | 2027 | 2030 | MA | AKSHI, Universitete | - | - | - | - |

# ANEKS 1 - MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT

**ANEKS 1**
**MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT**
**AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2027-2030**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi strategjik I:** | **Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore për të garantuar një sistem të mirë koordinuar dhe të financuar, që mundëson respektimin, mbrojtjen, përmbushjen dhe monitorimin efektiv të të drejtave të fëmijëve.** | | | |
| **Objektivi specifik I.1:** | **Fuqizimi i institucioneve dhe mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët** | | | |
| **Rezultati i pritshëm:** | Sistemi i qeverisjes për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri funksionon në mënyrë të koordinuar, të bazuar në të dhëna dhe të mbështetur nga financim i qëndrueshëm, duke siguruar zbatimin efektiv të politikave dhe monitorimin e progresit në nivel qendror dhe vendor. | | | |
| **Treguesi:** | Numri i specialistëve të ASHDMF-së të angazhuar në koordinimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve. | | **Baseline (2026):** 9 punonjës | **Target (2030):** 11 punonjës (22% më tepër) |
| | Numri i raporteve kombëtare të publikuara mbi situatën dhe progresin e të drejtave të fëmijëve (përfshin raportet e progresit dhe analizat statistikore) | | **Baseline (2025):** Analiza tematike e Cens 2030 për fëmijët dhe të rinjtë[8] | **Target (2030):** të paktën 4 raporte kombëtare vjetore të publikuara (2027–2030) |
| | Përqindja e treguesve të OZHQ me fokus fëmijët të raportuara në mënyrë të rregullt | | **Baseline (2025):** 60%[9] | **Target:** 80% |
| **MASAT DHE AKTIVITETET** | **REZULTATET** | **INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE** | **INSTITUCIONET PARTNERE** | **AFATI KOHOR** |
| **I.1.1 Qeverisje ndër-sektoriale funksionale dhe llogaridhënie për zbatimin e politikave për fëmijët** | | | | |
| *1.1.1.a Vlerësimi i zbatimit të ligjit për të drejtat e fëmijëve*<br><br>*1.1.1.a/1 Hartimi i propozimeve për rishikimin e ligjit "Për të drejtat e fëmijëve" për të forcuar arkitekturën institucionale për zbatimin e ligjit të të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.* | *Propozimet për ndryshimin ligjor, mbi bazën e gjetjeve të vlerësimit* | *MSHMS, ASHMDF* | *Ministritë e linjës, NJVV, Partner* | *2028-2029* |

[8] https://www.instat.gov.al/media/jghp25ox/f%C3%ABmij%C3%ABt-dhe-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-censi-2023.pdf
[9] https://www.transmonee.org/child-related-sdg-progress-dashboard

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *I.1.1.b Rivitalizimi dhe garantimi i qëndrueshmërisë së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF), si mekanizëm qendror për koordinimin, monitorimin dhe raportimin ndërsektorial të zbatimit të politikave për fëmijët, përmes zhvillimit të rregullt të veprimtarisë së tij dhe forcimit të rolit institucional.* | *Numri i takimeve të KKDM gjatë vitit* | *MSHMS* | *ASHMDF, ministritë e linjës, institucionet e tjera pjesë e KKDMF-së* | *2027-2030* |
| *I.1.1.c Integrimi i çështjeve të fëmijëve në agjendën e punës së Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara, në koordinim me Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve (KKDMF)* | *Numri i çështjeve të ngritura në takimet e GMIP në fushën e të drejtave të fëmijëve (2 takime)* | *MSHMS* | *ASHPSKN* | *2027-2030* |
| *1.1.1.ç Rritja buxhetit të ASHMDF për ushtrimin e rolit drejtues, koordinues dhe monitorues në nivel kombëtar dhe vendor për zbatimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.* | *Buxhet i rritur* | *MSHMS, ASHMDF* | | *2027-2030* |
| *I.1.1.d Hartimi dhe raportimi vjetor i zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve në KKMDF dhe Parliament – Grupi parlamentar "Miqtë e fëmijëve".* | *Raport vjetor i progresit të Agjendës i publikuar dhe i diskutuar në KKDMF dhe në Kuvend.* | *ASHMDF* | *MSHMS* | *2027-2030* |
| *I.1.1.dh Forcimi i raportimit vjetor të institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut mbi trajtimin e ankesave dhe monitorimin e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, përfshirë integrimin e të dhënave për të drejtat e fëmijëve në raportet e tyre vjetore dhe raportimin në KKDMF dhe Grupin Parlamentar "Miqtë e Fëmijëve"* | *Numri i institucioneve të pavarura që raportojnë çdo vit mbi të drejtat e fëmijëve dhe përfshijnë të dhëna specifike për fëmijët në raportet e tyre vjetore* | *Avokati i Popullit, KMD, KDIMDHP* | *MSHMS* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *1.1.1.e. Zhvillimi i një mekanizmi monitorues (dashboard) për ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve (CRC, CEDAW, UPR).* | *Mekanizmi i hartuar dhe funksional* | *MSHMS, MEPJ* | *ASHMDF Ministri të linjës* | *2027-2029* |
| *I.1.1.ë Zhvillimi dhe institucionalizimi i metodologjisë për buxhetimin e ndjeshëm ndaj fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. Trajnimi i specialisteve mbi metodologjinë.* | *Metodologji kombëtare e miratuar dhe e përdorur nga ministritë dhe bashkitë.* | *MSHMS, MF, ASPA* | *Partnerë* | *2028-2030* |
| *I.1.1.f Ngritja dhe funksionimi i një grupi pune ndër-sektoriale për të hartuar dhe koordinuar iniciativën e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët, në koordinim me KKDMF.* | *Grupi koordinues i ngritur; Udhëzuesi për zbatimin e qyteteve miqësore për fëmijët / adoleshentët i hartuar* | *ASHMDF, AMVV, NJVV* | *MSHMS* | *2028-2030* |
| *I.1.1.g Integrimi i çështjeve të fëmijëve dhe i qasjes së bazuar në të drejtat e fëmijës në politikat dhe planet për menaxhimin e emergjencave civile dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke garantuar mbrojtjen, mirëqenien dhe vazhdimësinë e shërbimeve për fëmijët gjatë krizave.* | *Plani kombëtar dhe ato vendore të emergjencave kanë përfshirë adresimin e efekteve tek fëmijët* | *MPB AKMC* | *ASHDMF, MSHMS, ISHP* | *2027-2030* |
| *I.1.1.gj Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet ASHDMF-së, Agjencisë Kombëtare së Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHTI), institucioneve akademike dhe aktorëve të tjerë relevantë, për zhvillimin dhe promovimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve* | *Marrëveshje e lidhur mes ASHDMF dhe AKKSHI Numri i takimeve me institucionet akademike dhe kërkimore në fushën e të drejtave të fëmijëve* | *ASHDMF, AKKSHTI* | *Universitetet, institucionet kërkimore, INSTAT* | *2027-2030* |
| *I.1.1.h Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet ASHDMF-së dhe organizatave të shoqërisë civile për forcimin e rolit të tyre në ndërgjegjësimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve.* | *Numri i takimeve të përbashkëta të zhvilluara ndërmjet* | *ASHMDF* | *AMSHC, MSHMS* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *ASHDMF-së dhe OSHC-ve në vit Numri i OSHC-ve pjesëmarrëse* | | | |
| *I.1.1.i Zhvillimi dhe integrimi i moduleve mbi etikën profesionale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në programet e studimit të gazetarisë dhe komunikimit, me fokus në raportimin etik, konfidencialitetin dhe trajtimin e rasteve që përfshijnë të mitur.* | *Numri i moduleve të zhvilluara mbi etikën dhe të drejtat e fëmijëve për programet e gazetarisë* | *ASHDMF, MA, Fakulteti i Gazetarisë* | *AMA* | *2027-2028* |
| *I.1.1.j Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve, profesionistëve të komunikimit publik dhe pikave fokale për të drejtat e fëmijëve në institucionet publike dhe jo-publike mbi të drejtat e fëmijëve, komunikimin etik, mbrojtjen e privatësisë dhe raportimin e përgjegjshëm të çështjeve që lidhen me fëmijët.* | *Numri i institucioneve publike me staf të trajnuar për komunikimin mbi të drejtat e fëmijëve* | *ASHDMF, MA, AMA, ASPA* | *Institucionet publike, OJF* | *2027-2030* |
| **I.1.2 Forcimi i sistemit kombëtar të të dhënave, statistikave dhe evidencës për fëmijët dhe adoleshentët** | | | | |
| *I.1.2.a Përfshirja e treguesve me fokus fëmijët dhe adoleshentët në MoU e INSTAT dhe instituiconeve shtetërore ne zbatim të programit të ri të Statistikave zyrtare* | *Numri i treguesve me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë të integruar të raportuar në kuadër të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare* | *INSTAT* | *Ministritë e linjës* | *2027* |
| *I.1.2.b Planifikimi i punës për hartimin e anketës MICS 2030* | *Plani i punës për hartimin dhe zbatimin e Anketës MICS 2030 i miratuar* | *INSTAT* | *Ministritë e linjës* | *2029-2030* |
| *I.1.2.c Përgatitja dhe publikimi çdo tre vjet i botimit analitik statistikor për fëmijët dhe adoleshentët.* | *Botim analitik statistikor i publikuar çdo 3 vite* | *INSTAT* | *Ministritë e linjës, Partnerë* | *2027+2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *I.1.2.ç Përditësimi çdo vit i platformës digjitale me të dhënat zyrtare për fëmijët dhe adoleshentët. Komunikimi i rregullt me partnerët mbi të dhënat.* | *Dashboard kombëtar i përditësuar me të dhëna të disagreguara për fëmijët.* | *INSTAT, ASHDMF* | *Ministritë e linjës, Partnerë* | *2027-2030* |
| *I.1.2.d Krijimi i grupit të punës dhe kryerja e vlerësimit mbi ekosistemin e të dhënave/statistikave me fokus fëmijët dhe aoleshetnët në shqipëri.* | *Grupi i punës i institucionalizuar* | *MSHMS, INSTAT* | | *2028* |
| *I.1.2.dh Përgatitja e një analize gjithëpërfshirëse dhe të përditësuar mbi situatën e fëmijëve* | *Raporti analitik i publikuar mbi situatën me mbështetje expertet* | *MSHMS, INSTAT* | *ASHMDF, Ministritë e linjës, Partnerë* | *2028 - 2029* |
| *I.1.2.e Përditësimi dhe promovimi i platformës kombëtare të statistikave për fëmijët (statistikafemijet.gov.al) me të dhëna të standardizuara nga institucionet përgjegjëse* | *Platforma statistikore për fëmijët e përditësuar rregullisht dhe e përdorur për monitorimin e politikave për të drejtat e fëmijëve.* | *ASHMDF* | *INSTAT, Ministritë e linjës dhe NJVV* | *2027-2030* |
| **I.1.3. Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve** | | | | |
| *I.1.3.a Ngritja e strukturave/mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror (prane KKMDF, parlament, institucionet e pavarura, etj) dhe vendor* | *Këshilli i fëmijëve ngritur në nivel qendror në të paktën 4 Bashki të vendit* | *MA, MSHMS* | *Partner* | *2027-2030* |
| *I.1.3.b Hartimi dhe shpërndarja e materialeve informuese në gjuhë miqësore për fëmijët mbi KDF, AKDF 2027–2030 dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve, duke siguruar aksesueshmëri për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e komuniteteve rome dhe egjiptiane.* | *Numri i materialeve të përshtatura në gjuhë miqësore për fëmijët duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara* | *ASHDMF* | *Partner* | *2027* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *dhe komunitetet rome dhe egjiptiane.* | | | |
| *I.1.3.c Përmirësimi i mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor përmes rishikimit dhe përditësimit të Urdhrit nr. 367, datë 09.06.2020.*[10] | *Urdhër për pjesëmarrjen e fëmijëve e vlerësuar, e rishikuar dhe e miratuar* | *MSHMS, ASHDMF* | *Partner* | *2027-2028* |
| *I.1.3.ç Fuqizimi i qeverive dhe parlamenteve të nxënësve, si dhe i strukturave të tjera të pjesëmarrjes së fëmijëve, për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrjes kuptimplotë të tyre, duke siguruar përfshirjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël, përfshirë fëmijët romë, egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.* | *Numri i shkollave ku qeveritë, parlamentet e nxënësve dhe strukturat e tjera të pjesëmarrjes së fëmijëve angazhohen në aktivitete dhe iniciativa që promovojnë të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre* | *MA* | *ASHDMF, AKAP, DRAP, ZVAP, NJVV, OJF* | *2027-2030* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Qëllimi strategjik II:** | **Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve** | | |
| **Objektivi specifik II.1:** | **Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.** | | |
| **Rezultati i pritshëm:** | Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe ndryshimi i qëndrimeve shoqërore që tolerojnë dhunën ndaj fëmijëve, duke kontribuar në uljen e pranueshmërisë sociale të dhunës dhe rritjen e raportimit të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve. | | |
| **Treguesi:** | Përqindja e popullsisë që konsideron të papranueshme përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve. | **Baseline:**<br>55% e popullsisë e konsideron të papranueshme | **Target 2030:**<br>85% e popullsisë e konsideron të papranueshme |

[10] Urdhër nr. 367, datë 09.06.2020 "Për miratimin e udhëzuesit 'Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes në aktivitetet, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët'.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve[11] | përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve |
| | Përqindja e femrave 20–24 vjeç që kanë lidhur martesë ose kanë bashkëjetuar për herë të parë:<br>• para moshës 18 vjeç | | **Baseline:**<br>11.8% | **Target 2030:**<br>8% |
| | Përqindja e fëmijëve të moshës 1–14 vjeç që kanë përjetuar metoda disiplinimi të dhunshme ose jo të dhunshme nga prindërit/kujdestarët gjatë muajit të fundit. | | **Baseline:**<br>47.5% | **Target 2030:**<br>30% |
| | Përqindja e fëmijëve të moshës 5–17 vjeç të përfshirë në aktivitete ekonomike dhe/ose punë të rrezikshme për fëmijët. | | **Baseline:**<br>Do të publikohet në shtator 2026 nga INSTAT | **Target 2030:**<br>3% më pak se baseline |
| **MASAT DHE AKTIVITETET** | **REZULTATET** | **INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE** | **INSTITUCIONET PARTNERE** | **AFATI KOHOR** |
| **II.1.1. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe ndryshimi i normave sociale që tolerojnë dhunën ndaj fëmijëve** | | | | |
| *II.1.1.a ASHDMF, në bashkëpunim me partnerë, mbështet realizimin e një studimi të pavarur kombëtar (2027–2029) për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të popullsisë ndaj dhunës ndaj fëmijëve, të realizuar nga institucione të specializuara sipas metodave shkencore të kërkimit.* | *Publikimi i dy raporteve kombëtare mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat lidhur me dhunën ndaj fëmijëve* | *ASHDMF, MSHMS* | *Partner* | *2027-2030* |
| *II.1.1.b Hartimi i një plani kombëtar komunikimi për adresimin e normave negative sociale që justifikojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve.* | *Plani i komunikimit i përfunduar;*<br>*Numri i produkteve me mesazhe komunikimi të përgatitur;* | *ASHDMF, MSHMS* | *NJVV, Partner* | *2027-2028* |

[11] UNICEF Albania. The Reporting of Violence Against Children in Albania https://ëëë.unicef.org/albania/media/6601/file/The%20Reporting%20of%20Violence%20Against%20Children%20in%20Albania.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *II.1.1.c Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve informuese (video, guida, fletëpalosje, materiale digjitale) mbi:*<br>- *të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve*<br>- *pasojat e dhunës*<br>- *mënyrat e raportimit dhe mbrojtjes.* | *Numri. i materialeve informuese të zhvilluara*<br>*Numri i materialeve të shpërndara në shkolla dhe komunitet* | *ASHDMF, MSHMS* | *NJVV, Partner* | *2027-2030* |
| *II.1.1.ç Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në nivel kombëtar dhe lokal mbi të drejtat e fëmijëve, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre të shëndetshëm, pa dhunë, siguri digjitale, prindërim pozitiv dhe parandalimin e sjelljeve të dëmshme për fëmijët.* | *Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese çdo vit* | *MSHMS* | *MKR, NJVV, ASHMDF, IPSH, OSHKSH, AP KRAT*<br>*AMA, OJF*<br>*ON, TV Kombëtare dhe Lokale*<br>*Qendra Komunitare Multi-funksionale* | *2027-2030* |
| *II.1.1.d Angazhimi i mediave, figurave publike, krijuesve të përmbajtjes dhe aktorëve të tjerë me ndikim shoqëror në promovimin e mesazheve kundër dhunës ndaj fëmijëve, përmes fushatave të koordinuara dhe komunikimit publik të bazuar në standarde etike.* | *Numri i mediave të përfshira në fushata*<br>*Numri i liderëve komunitarë dhe figurave publike të angazhuara* | *ASHDMF, AMA, MSHMS* | *Media, OSHC, NJVV* | *2027-2030* |
| *II.1.1.dh Rivitalizimi dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ASHDMF-së dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për promovimin e raportimit etik dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në media, përmes zhvillimit të takimeve të rregullta, udhëzimeve dhe mekanizmave monitorues.* | *Marrëveshje bashkëpunimi midis ASHDMF dhe AMA* | *ASHDMF, AMA* | *MSHMS, Partnerë* | *2027* |
| *II.1.1.e Zhvillimi dhe zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese me industrinë e turizmit, operatorët turistikë, strukturat akomoduese dhe publikun e gjerë për* | *Numri i fushatave ndërgjegjësuese të* | *MTKS, ASHDMF* | *Partner, OJF* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në kontekstin e udhëtimit dhe turizmit, si dhe promovimi dhe zbatimi i Kodit Global të Etikës për Turizmin dhe standardeve të mbrojtjes së fëmijëve në sektorin e turizmit.* | *zhvilluara me sektorin e turizmit.* | | | |
| **II.1.2. Promovimi i prindërimit pozitiv dhe mbështetja e familjeve për rritjen e fëmijëve pa dhunë** | | | | |
| *II.1.2.a Hartimi dhe përditësimi periodik i Udhëzuesit Kombëtar për Prindërimin Pozitiv dhe materialeve të aksesueshme për prindër dhe profesionistë të shërbimeve sociale, arsimit dhe shëndetësisë.* | *Moduli standard ndërsektorial për prindërimin pozitiv i hartuar, miratuar dhe publikuar* | *MSHMS, MA* | *ASHDMF, SHSSH, ISHP, QKTRF, NJVV, Partner, ISHP, Universitete, OJF* | *2027-2028* |
| *II.1.2.b Integrimi i komponentëve të prindërimit pozitiv në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor (p.sh. gjatë vizitave rutinë për nënat dhe fëmijët) dhe në aktivitetet edukative në shkolla, si mekanizma të hershëm identifikimi dhe mbështetjeje për familjet* | *Përqindja e njësive të kujdesit shëndetësor parësor dhe institucioneve arsimore që zbatojnë komponentë të prindërimit pozitiv në shërbimet dhe aktivitetet e tyre rutinë.* | *MSHMS, MA* | *ASHDMF, DRSH, ZVA, NJVV* | *2027-2028* |
| *II.1.2.c Zbatimi i programeve ndërgjegjësuese dhe edukative për prindërit/ kujdestarët ligjorë, familjarë përmes qendrave komunitare, shkollave dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor si pika hyrëse për familjet mbi parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe promovimin e praktikave pozitive të prindërimit.* | *Numri i programeve të prindërimit pozitiv të realizuar në nivel vendor* | *NJVV, ASHDMF* | *Partner, OJF* | *2027-2030* |
| *II.1.2.ç Ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes psikosociale për prindërit përmes shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, mbi prindërimin pozitiv, menaxhimin e konflikteve familjare, zhvillimin emocional të fëmijëve dhe ndarjen e përgjegjësive prindërore, si dhe mbi përballimin e situatave të* | *Numri i sesioneve/takimeve me fokus këshillim* | *NJVV, ZVA, OSHKSH* | *MSHMS, OJF* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *vështira, varësive, sjelljeve të rrezikshme dhe faktorëve të tjerë që cenojnë mirëqenien e fëmijëve.* | *dhe mbështetje psikosociale* | | | |
| *II.1.2.d Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të strukturuara të informimit, këshillimit dhe mbështetjes psikosociale për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuar, me fokus fuqizimin e familjes dhe mbështetjen e zhvillimit të fëmijës.* | *Numri i programeve të këshillimit dhe mbështetjes psikosociale* | *NJVV, ASHDMF* | *MA, MSHMS, ASHDMF, OJF, Partnerë* | *2027-2030* |
| *II.1.2.dh Bashkëpunimi me median për promovimin e modeleve pozitive të prindërimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi praktikat e rritjes pa dhunë* | *Numri i aktiviteteve dhe produkteve mediatike të realizuara në bashkëpunim me median për promovimin e prindërimit pozitiv.* | *ASHDMF, NJVV, AMA* | *Partner* | *2027-2030* |
| **II.1.3. Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve në mjedisin shkollor dhe promovimi i një kulture pozitive në shkolla** | | | | |
| *II.1.3.a Zhvillimi dhe zbatimi i programeve edukative në shkolla mbi:*<br>- *parandalimin e bullizmit dhe dhunës*<br>- *dhunën mes bashkëmoshatarëve*<br>- *respektin dhe tolerancën*<br>- *barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin*<br>- *menaxhimin e sjelljes dhe përfshirjen sociale* | *Numri i programeve edukative të zbatuara në shkolla* | *ZVA, ASHDMF, NJVV* | *MA, MSHMS, Partner* | *2027-2030* |
| *II.1.3.b Organizimi i workshop-eve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese për nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi identifikimin e hershëm të dhunës, mekanizmat e raportimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse në mekanizmin e referimit ndërinstitucional.* | *Numri i workshop-eve të organizuara* | *ZVA, ASHDMF, NJVV (NJMF)* | *MA, MSHMS, Partner* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *II.1.3.c Forcimi i sigurisë në shkolla përmes rritjes së numrit të oficerëve të sigurisë dhe përcaktimit të rolit të tyre në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e referimit* | *Numri i oficerëve të sigurisë i dyfyshuar (500 oficerë)* | *MA, MPB, ASHDMF* | *MSHMS* | *2027* |
| *II.1.3.ç Krijimi i iniciativave të udhëhequra nga adoleshentët për promovimin e një kulture shkollore pa dhunë, përmes ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve, aktiviteteve sensibilizuese dhe nismave kundër bullizmit, në bashkëpunim me strukturat e shkollës dhe shërbimet vendore të mbrojtjes së fëmijëve* | *Numri i iniciativave të udhëhequra nga të rinjtë në shkolla* | *ZVA, ASHDMF, NJVV* | *MA, MSHMS, Parner* | *2027-2030* |
| *II.1.3.d Trajnimi i mësuesve, psikologëve, oficerëve të sigurisë dhe punonjësve socialë për identifikimin e hershëm të rasteve, referimin sipas procedurave standard, menaxhimin fillestar të rasteve në koordinim me NJMF dhe strukturat vendore* | *Numri i mësuesve, psikologëve, oficerëve të sigurisë, punonjësve sociale të trajnuar* | *MA, ASCAP* | *MSHMS, NJVV, ASHDMF, MB* | *2027-2028* |
| *II.1.3.dh Investime në infrastrukturën arsimore*<br>- *ndërtimi dhe pajisja e hapësirave bashkëkohore brenda dhe jashtë shkollës për të inkurajuar aktivitete sportive*<br>- *ndërtimi dhe rikonstruksioni i institucioneve arsimore*<br>- *hapësira dhe mekanizma mbështetës për mirëqenien emocionale dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirë klasa mbështetëse dhe ambiente për ndërhyrje individuale dhe rregullim emocional.* | *Numri i institucioneve arsimore të investuara* | *MA* | *NJVV* | *2027-2030* |
| *II.1.3.e Rritje e numrit të punonjësve të shërbimit psikosocial si dhe e kapaciteteve të tyre për mirëqënien e nxënësve në shkolla duke siguruar lidhje funksionale me NJMF dhe shërbimet sociale për ndjekjen e rasteve.*<br>*+350 punonjës të shërbimit psikosocial* | *350 punonjës të shërbimit psikosocial të punësuar (1200 punonjës të shërbimit psikosocial deri në 2027)* | *MA* | *ASHDMF* | *2027* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *II.1.3. ë Zhvillimi i kornizës së politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore, në përputhje me sistemin kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e referimit.* | *Dokumenti kornizë i politikave të mbrojtjes së fëmijëve i hartuar dhe miratuar* | *MA* | *Partner* | *2027-2028* |
| *II.1.3.f Hartimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve nga vetë institucionet arsimore me pjesëmarrjen e fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si iniciativë e cdo shkolle (udhëhequr nga senatet e fëmijëve dhe këshilli i prindërve)* | *Numri i shkollave me politika të mbrojtjes së fëmijëve të hartuar dhe miratuar* | *MA, ASHDMF* | *Partner, MSHMS* | *2027-2028* |
| *II.1.3.g Forcimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe mbështetjes psikosociale në kopshte dhe shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes rritjes së mbulimit me mësues ndihmës, staf psikosocial dhe mekanizma mbështetës për menaxhimin e sjelljes dhe përfshirjen sociale.* | *Numri i shkollave me mësues ndihmës dhe staf psikosocial funksional* | *MA* | *MSHMS, ASHDMF, NJVV* | *2027-2030* |
| **II.1.4. Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes edukimit mbi sigurinë digjitale, përdorimin e sigurt të internetit, parandalimin dhe raportimin e dhunës online, si dhe mbrojtjen e privatësisë dhe integritetit të tyre në mjedisin digjital** | | | | |
| *II.1.4.a Zgjerimi i aksesit të fëmijëve në internet dhe teknologji digjitale, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, përmes përmirësimit të infrastrukturës digjitale, forcimit të aftësive dhe kompetencave digjitale të fëmijëve, mësuesve dhe familjeve* | *Përqindja e shkollave me akses në internet* | *MA* | *Partner* | *2027-2028* |
| *II.1.4.b Integrimi i edukimit për sigurinë digjitale dhe identifikimin e rreziqeve në mjedisin online në programet e edukimit në shkolla.* | *Numri i shkollave që zbatojnë programe për sigurinë digjitale* | *MA, ASCAP* | *ZVA, Shkollat, Partner* | *2027-2029* |
| *II.1.4.c Zhvillimi dhe zbatimi i ndërhyrjeve të integruara për sigurinë e fëmijëve në internet, për fëmijët, prindërit dhe komunitetin shkollor, përmes materialeve informuese, programeve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e sigurt të internetit dhe parandalimin e rreziqeve digjitale.* | *Numri i programeve edukative të zhvilluara (vjetor)*<br>*Numri i materialeve informuese të zhvilluara dhe të shpërndara* | *NJVV, ZVA, ASHDMF, AKSK* | *OJF, Partner* | *2027-2030* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Numri i fushatave ndërgjegjësuese* | | | |
| *II.1.4.ç Zhvillimi i programeve të trajnimit për prindërit mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe përdorimin e sigurt të teknologjisë për fëmijët dhe procedurat bazë për kërkimin e ndihmës dhe raportimin e rasteve.* | *Numri i programeve të trajnimit për prindërit* | *NJVV, ASHDMF, AKSK* | *Partner* | *2027-2030* |
| *II.1.4.d Hartimi dhe zbatimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe ASHDMF-së për forcimin e mekanizmave të identifikimit, referimit, koordinimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve viktima ose në rrezik të dhunës, bullizmit kibernetik, grooming, shfrytëzimit seksual online dhe formave të tjera të rrezikut në mjedisin digjital.* | *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe ASHDMF-së e hartuar dhe e nënshkruar;* | *Policia e Shtetit, ASHDMF* | *MSHMS, MA, AKSK, DRAP/ZVAP, NJVV, OJF, Partnerë* | *2027* |
| *II.1.4.dh Përditësimi i protokolleve/procedurave për sigurinë në shkolla duke përfshirë:*<br>- *sigurinë kibernetike dhe sjelljen etike në mjediset digjitale*<br>- *procedurat për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës digjitale ndaj fëmijëve*<br>- *lidhjen me mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve (NjMF, Policia e Shtetit, strukturat përkatëse)* | *Protokolle/procedura të përditësuara dhe të miratuara për sigurinë digjitale në shkolla;* | *MA, ASHDMF, AKSK, PSH* | *NJVV, Partner* | *2027-2028* |
| *II.1.4.e Krijimi dhe funksionalizimi i një rrjeti kombëtar të mbështetjes digjitale për sigurinë online dhe mirëqenien e nxënësve, që përfshin:*<br>- *platforma dhe linja këshillimi për fëmijët dhe prindërit*<br>- *mekanizma të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për raportimin e rasteve*<br>- *orientimin e rasteve drejt strukturave të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit (NjMF, Policia, Prokuroria sipas rastit)* | *Rrjet kombëtar funksional për mbështetjen e sigurisë online (numri i individëve të angazhuar)*<br>*Numrii i rasteve të raportuara përmes mekanizmave digjitalë* | *MA, AKSK* | *Partner* | *2027-2028* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik II.2:** | **Përmirësimi i kuadrit normativ si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje** | | |
| **Rezultati i pritshëm:** | Kuadri normativ dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve janë përmirësuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive për identifikimin dhe reagimin e koordinuar ndaj rasteve të dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. | | |
| **Treguesit:** | Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara ose të përditësuara për forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. | **Baseline:** Kuadri normativ ekzistues kërkon përditësim dhe harmonizim të mëtejshëm | **Target**:<br>3–4 akte ligjore/nënligjore të miratuara ose të përditësuara |
| | Përqindja e bashkive që kanë funksionale mekanizmat për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. | **Baseline:**<br>51<br>100% e bashkive kanë mekanizma të ngritur | **Target:**<br>100% e bashkive kanë mekanizma funksionalë dhe efektivë |
| | Numri i rasteve të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuara dhe të trajtuara përmes mekanizmave të referimit. | **Baseline: 2024**<br>1386[12] | **Target:**<br>20% më tepër e numrit të rasteve të reja të identifikuara dhe të trajtuara |
| | Numri i rasteve të raportuara të dhunës ndaj fëmijëve të mbyllura brenda afatit të përcaktuar nga protokollet e mbrojtjes së fëmijëve. | **Baseline: 2024**<br>741[13] | **Target:**<br>20% më tepër e numrit të rasteve të raportuara të dhunës ndaj fëmijëve të mbyllura |

[12] ASHDMF
[13] ASHDMF

| MASAT DHE AKTIVITETET | REZULTATET | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **II.2.1 Forcimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe acquis të Bashkimit Evropian** | | | | |
| *II.2.1.a Rishikimi i Kodit të Familjes në kuadër të harmonizimit me ndryshimet ligjore të Ligjit 18/2017 për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ligje të tjera që përmbajnë parashikime specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve* | *Kodi i familjes i rishikuar.*<br>*Spekti (përmbajtja) e ndryshimeve.* | *MD, MPB, MSHMS* | *Partner, ASHDMF* | *2027-2029* |
| *II.2.1.b Rishikimi i Kodit Penal për ta sjellë në linjë me legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë dispozitat që lidhen me trafikimin e fëmijëve, abuzimin seksual dhe format online të dhunës të kryera ndaj fëmijëve* | *Kodi Penal i rishikuar.*<br>*Spekti (përmbajtja) e ndryshimeve.* | *MD, MPB,* | *Partner*<br>*Policia e Shtetit, MSHMS, ASHDMF* | *2027-2030* |
| *II.2.1.c Rishikimi i Ligjit nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", me qëllim harmonizimin e tij me ndryshimet e Ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror" dhe forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.* | *Akt ligjor i rishikuar dhe miratuar* | *MSHMS* | *Partner, MD* | *2027-2028* |
| *II.2.1.ç Rishikimi i VKM-së nr.111 "për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës"* | *Akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar* | *MSHMS, ASHDMF, MPB* | *Partner* | *2027* |
| *II.2.1.d Rishikimi i udhëzimit nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, 'Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor'", me qëllim heqjen e barrierave ligjore që lidhen me mbulimin e tarifave të ekspertëve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të miturit.* | *Akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar* | *MD* | | *2027* |
| *II.2.1.dh Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të brendshëm ndërinstitucional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve online* | *Udhëzim i miratuar* | *MD, MSHMS, MPB* | *AKSK, AKEP, ASHDMF, AMA, Policia e Shtetit* | *2027* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *II.2.1.e Miratimi i metodologjisë për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës* | *Metodologji e miratuar* | *MSHMS, ASHDMF* | *Partner* | *2027* |
